

NXITJA E SHPENZIMEVE NË NIVELIN LOKAL ME FOKUS NË TË DREJTAT E FËMIJËVE

Një studim i buxhetit të Komunës së Pejës me fokus në promovimin e të drejtave të fëmijëve

Realizuar nga:

Instituti për politika zhvillimore (INDEP)

Përkrahur nga:

Save the Children

Dizajni, rradhitja dhe shtypi:

Envinion

Publikuar nga:

Save the Children

Gazmend Zajmi, nr. 01

10000 Pristina, Kosova/o

Tel: +381 (0) 38 23 26 91

Fax: +381 (0) 38 23 26 93

scik@savethechildren.org

<http://kosovo.savethechildren.net>

© 2014 Save the Children

Ky publikim është i mbrojtur nga e drejta e autorit, mund të kopjohet për qëllime edukative, por nuk është për shitje.

Për çfarëdo lloj përdorimi duhet paraprakisht të merret leja nga botuesi.

Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe kompanisë që ka zhvilluar hulumtimin dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë mendimet e organizatës Save the Children.

Si pjesë e sistemit të llogaridhënies së Save the Children: Nëse keni ndonjë ankesë, pyetje apo informatë kthyesë (feedback), ju lutem na kontaktoni në: scik@savethechildren.org

PËRMBAJTJA

Vështrim i përgjithshëm.....	1
Hyrje	1
Synimi i studimit.....	2
Metodologjia	2
Kosova – profili makroekonomik	3
Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në Kosovë	5
Investimi në fëmijë ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.....	6
Cikli i përpilimit të buxhetit në nivel qendror dhe lokal	7
Analizë e Buxhetit Komunal	8
Një profil i Komunës së Pejës	8
Vështrim mbi financimin e qeverisjes lokale.....	9
Analizë e sektorit të shëndetësisë në Kosovë.....	11
Baza ligjore për shëndetësi.....	12
Shpenzimet për kujdesin mjekësor në Kosovë.....	13
Shpenzimet për shëndetësi në Komunën e Pejës.....	14
Mjekësia primare në Pejë – analizë e gjendjes	16
Kordinimi i buxhetit për shëndetësi me nevojat e fëmijëve në Komunën e Pejës.....	18
Vështrim i sistemit të arsimit në nivelin qendror dhe lokal.....	19
Baza ligjore për sektorin e arsimit.....	21
Shpenzimet për arsim në nivelin qendror	22
Analizë e buxhetit për arsim në Komunën e Pejës.....	24
Problemet në fushën e arsimit në Pejë	25
Rregullimi i planifikimit buxhetor për t’ju përgjigjur më mirë nevojave të fëmijëve në fushën e arsimit në Pejë.....	26
Sektori i mirëqenies sociale në Kosovë	28
Paketa ligjore që mbrojnë të drejtat e fëmijëve	30
Financimi i shërbimeve sociale si një nga kompetencat e deleguara të komunave.....	31
Trendët e përgjithshme të financimit në Komunën e Pejës	32
Skema e asistencës sociale	33
Mbështetja e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara.....	34
Strehimi familjar	35
Dedikimi i limituar i shërbimeve sociale për mirëqenien e fëmijëve në Komunën e Pejës	36
Përfundime dhe rekomandime.....	37
Zgjidhjet e zbatueshme për të rritur shpenzimet në nivel lokal për promovimin e të drejtave të fëmijëve	39
Shtojcat	42

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Ky raport është një prezantim i gjetjeve kryesore në lidhje me shkallën e reflektimit të nevojave e fëmijëve në buxhetin komunal të komunës së Pejës. Si i tillë ky raport është i ndarë në tri pjesë:

- a) ofrimi i një pamje gjithëpërfshirëse të zhvillimit social dhe makroekonomik të vendit, të cilët ndikojnë direkt në marrjen e vendimeve në nivelin lokal;
- b) rishikim i shpenzimeve të buxhetit të Komunës për periudhën 2010-2014;
- c) analizë kualitative dhe një përfaqësim i gjetjeve kryesore të pasuara nga rekomandime praktike.

HYRJE

Viti 2014 shënon përvjetorin e 25-të të ratifikimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve. Përderisa synimi fillestar i Konventës ka qenë që t'i promovoj të drejtat e fëmijëve në nivel botëror, situata në shumë vende që kanë ratifikuar këtë Konventë është ende e pakënaqshme. Neni 4 i kësaj Konvente i vë obligim të gjitha qeverive që të investojnë për fëmijët “në nivelin maksimal të burimeve të tyre” në mënyrë që të realizohen objektivat e Konventës.¹ Në këtë aspekt, përkundër faktit që Kosova është një prej shteteve që nuk e ka nënshkruar Konventën për shkaqe politike, Konventa është transponuar në kornizën ligjore në vend përmes Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Duke marrë parasysh këtë fakt si dhe faktin që Kosova është vendi me numrin më të madh të rinjve në rajon, Kosova ka një obligim për të krijuar politika favorizuese për mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve.

Në vijë me obligimet që dalin me këtë Konventë, Kosova ka marrë përsipër për të siguruar standardet minimale në fushën e shëndetësisë, strehimit, ushqimit, punës, dhe mirëqenies sociale, në mënyrë që t'ju garantohet fëmijëve një ambient i përshtatshëm për të jetuar. Megjithatë, në mënyrë që të përmbushen këto përgjegjësi, shtetet duhet të alokojnë mençur buxhetin e tyre dhe të menaxhojnë financat publike me maturi në mënyrë që të sigurohet kanalizimi i duhur i burimeve financiare drejt promovimit të drejtave të fëmijëve dhe të realizohet reflektimi i nevojave të tyre në skemat buxhetore dhe programet shtetërore. Siç është cekur në Strategjinë dhe Planin e Veprimit Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve në Republikën e Kosovës 2009-2013, “me siguri se duhet të pranohet se të drejtat e fëmijëve, edhe pse ato përbëjnë një sistem autonom të standardeve, janë të drejta të njeriut të cilat duhet të aplikohen në tërësi për fëmijët.”²

Edhe pse Kosova konsiderohet të jetë në fazën e tranzicionit në zhvillimin e saj, ka një nevojë urgjente që ajo të ndryshojë përpilimin e politikave me qëllim të adresimit të problemeve me një qasje nga nivelet më të ulëta udhëheqëse drejt nivelit qendror si dhe të aplikoj një strategji më të strukturuar në këtë drejtim. Kjo me fjalë të tjera i atribuohet përqendrimit të lartë që vendi dhe politik bërësit i kanë dhënë investimeve të mëdha kapitale, aktivitetëve shtet ndërtuese në aspektin politik, bashkëpunimit rajonal, dhe integritimit në BE. Duke bërë këtë, polit bërësit kanë tendencë të harrojnë t'i adresojnë problemet në fushën e edukimit, shëndetësisë, mirëqenies sociale, sigurisë së fëmijëve, etj. dhe të përkushtohen drejt investimeve në këto fusha. Përderisa ka pasur zhvillime të matshme por të vogla në këto sektorë, statistikatat tregojnë se vendi ende ngecë në zhvillimin dhe në ofrimin e kushteve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së. Mos zhvillimi i këtyre sektorëve ndikon direkt në zhvillimin e fëmijëve dhe pengon rëndë të drejtën e tyre për një jetesë të përshtatshme dhe normale.

1 Konventa e OKB-së mbi të drejtat e fëmijëve, (1989), OHCHR.

2 Strategjia dhe plani i veprimit mbi të drejtat e fëmijëve në Republikën e Kosovës 2009-2013, (2009), Zyra e Kryeministrit, Qeveria e Republikës së Kosovës.

SYNIMI I STUDIMIT

Në mënyrë që të kuptohet gjendja e të drejtave të fëmijëve në Kosovë, ky studim do të sjellë një analizë të promovimit të drejtave të fëmijëve në planifikimet buxhetore duke e fokusuar analizën në trendët mbizotëruese në njërin nga komunat e Kosovës. Komuna e Pejës është në vëmendje të këtij studimi, e cila njëkohësisht është komuna e dytë më e madhe në vend. Duke analizuar alokimin e buxhetit në komunën e përzgjedhur, ky raport i identifikon problemet dhe i liston rekomandimet se si mund të përmirësohen investimet në drejtim të përmirësimit të shfrytëzimit të resurseve shoqërore për avancim në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në këtë komunë.

Qëllimi i këtij rishikimi financiar dhe alokimit të buxhetit është që të forcoj zhvillimin e politikave me fokus të veçantë në shpenzimet e orientuara nga fëmijët. Duke identifikuar kufizimet fiskale, menaxheriale dhe të kapaciteteve në përgjithësi, analiza është orientuar drejt identifikimit të sugjerimeve relevante për politika konkrete që do të mund të integroheshin në planifikime buxhetore, veçanërisht të fokusuara në fushën e shëndetësisë primare, arsimin para universitar, si dhe dispozitat e shërbimeve sociale, të cilat do të sillnin zhvillime pozitive në këto sektorë që ndikojnë fuqishëm në zhvillimin e fëmijëve dhe mirëqenien e tyre.

Është një fakt i padiskutueshëm tashmë se investimet efektive dhe të orientuara drejt fëmijëve rezultojnë në progres ekonomik dhe social. Mirëqenia e fëmijëve përkthehet në përfitime më të mëdha produktive që rezultojnë në rritje ekonomike. Për këtë arsye shfaqet nevoja për një vlerësim thelbësor të efektshmërisë të shpenzimeve buxhetore, përshtatjen e alokimeve buxhetore, dhe reflektimin e nevojave komunale specifike në planifikimin buxhetor të komunës.

METODOLOGJIA

Një përzjerje e teknikave metodologjike cilësore dhe sasiore janë përdorur për të adresuar dhe për të mbledhur të dhëna për këtë studim. Më konkretisht, ky raport studimor është bazuar në një qasje të dyfishtë me teknika të ndryshme të hulumtimit në tavolinë dhe në terren të aplikuara në faza të ndryshme të kërkimit dhe procesit të analizimit. Metodatat e përdorura dhe strategjia kërkimore e aplikuar është si në vijim:

Kërkimet nga tavolina e dokumenteve relevante për promovimin e të drejtave të fëmijëve në Kosovë, që është fokusuar në identifikimin e dokumenteve kryesore, ligjeve, strategjive, planeve të veprimit, raporteve ndërkombëtare dhe raportet të cilat drejt për drejt e mbulojnë fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

Në mënyrë që të tërheqim paralele në mes të planifikimit buxhetor qendror dhe se si ai planifikim ndikon në politikbërjen lokale, ne kemi mbledhur të dhëna makroekonomike dhe specifike për vendin duke u bazuar në Buxhetin Kombëtar, Kushtetutën e Vendlit, Agjencinë e Statistikave të Kosovës, si dhe ueb faqet e ministrive përkatëse, që do të thotë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe Ministrisë së Arsimin, Shkencës dhe Teknologjisë. Për më shumë ne kemi mbledhur të dhëna nga raportet e Bankës Botërore, BE-së, dhe OKB-së për periudhën 2010-2014 të cilat konkretisht shënjojnë çështjet që direkt ndikojnë në jetët e fëmijëve, siç janë shkalla e varfërisë, korrupsioni, niveli i shkollimit dhe shkrim-leximit, niveli i përfshirjes sociale etj. Për më shumë hulumtimi ynë mbështetet fort në gjetjet e raporteve të ndryshme të KB-së dhe raportit të fundit të progresit me fokus në problemet që i takojnë fushës tonë të studimit, që do të thotë shëndetësisë, arsimin, dhe mirëqenies sociale, gjithmonë duke tentuar të tërheqim paralele krahasues me politikatat në nivelin qendror për të shikuar se si ato ndikojnë në problemet lokale.

Në mënyrë që t'i shkojmë në thelb problemit dhe të kuptojmë alokimet buxhetore në nivelin lokal, ne së pari kemi analizuar kornizën rregullative. Rrjedhimisht, raporti bën një përmbledhje të implikimeve të dispozitave ligjore të Ligjit për Buxhetin, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit mbi Familjen, Ligjit mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare, Ligjit të Shëndetësisë, Ligjit mbi Arsimin Para universitar, etj. Duke u

bazuar në këto ligje, ne ishim në gjendje që të kuptojmë se cilat politika janë politikat aktuale në vend në këto tri fusha dhe pritjet ligjore për secilin sektor, të cilat na kanë ndihmuar që të kuptojmë nëse politikat e planifikuara janë të koordinuara dhe në proporcion me vijat buxhetore.

Pas kësaj, duke u bazuar në Ligjet për Buxhetin ne kemi mbledhur të dhëna specifike për secilin sektor. Në bazë të këtyre të dhënave, ne kemi pasur mundësinë që të krijojmë trende për alokimet buxhetore dhe të identifikojmë nëse ka pasur ndryshime pozitive ose negative dhe të kuptojmë arsyet prapa tyre. Për më shumë, përmes raportit të shpenzimeve ne ishim në gjendje të kuptojmë efikasitetin e planifikimit dhe shpenzimeve buxhetore.

Gjithashtu, për të marrë të dhëna specifike për sektorët, ne ju kemi qasur raporteve të rregullta të Agjencisë së Statistikave të Kosovës mbi statistikave specifike të sektorëve të përzgjedhur. Duke u bazuar në këto të dhëna, ne ishim në gjendje të kuptojmë numrin e fëmijëve në komunë, praninë e komunitetit RAE, numrin e mjekëve, vizitave mjekësore, numrin e shkollave, etj. Këto të dhëna ishin shumë të dobishme për të na ndihmuar që të bëjmë një analizë më të thellë të gjendjes në këto sektorë në komunën e Pejës.

Faza e dytë dhe më e rëndësishme e hulumtimit ishte mbledhja e të dhënave primare. Kjo është arritur përmes dy aktiviteteve kryesore. Ne kemi zhvilluar intervista me politik bërës në nivelin qendror dhe lokal si dhe me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në Pejë që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve. Njëkohësisht kemi organizuar një fokus grup me 10 persona të përzgjedhur në pajtim me nevojat e studimit.

Në këtë pikë, synimi ishte të mësohen përvojat personale të palëve të interesit me projektet dhe angazhimet e tyre në këtë fushë, të vështrohet niveli i autonomisë në drejtim të alokimit dhe planifikimit të buxhetit në nivelin komunal, identifikimi i problemeve që i takojnë implementimit të programeve që kanë në fokus fëmijët, bashkëpunimi i përfaqësuesve lokal me donatorët ndërkombëtar dhe me qytetarët, vlerësimi i performancës së palëve të interesit dhe kuptueshmëria e asaj se sa kanë informata ata për implikimet e shpenzimeve buxhetore në nivel komunal etj.

Në mënyrë që të kuptojmë se çfarë zhvillime kanë ndodhur e që janë jashtë kornizës së planifikimit lokal ose qendror, ne gjithashtu kemi kontaktuar OJQ-të aktive që operojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve. Duke u bazuar në përvojën dhe dijen e tyre në fushën e studimit, ne mundëm të marrim informacione të cilave nuk kemi mund të ju qasemi 'online' ose përmes hulumtimit nga tavolina.

Për më shumë, ne kemi organizuar një fokus grup me qëllimin e vetëm për të marrë informata të dobishme nga një listë prej 10 personave nga radhët e palëve të interesit ku secili është përgjegjës për fusha të ndryshme brenda sektorëve të studimit. Synimi i këtij fokus grupi ishte që të shohim se si këta institucione, të përfaqësuara nga përfaqësuesit e tyre, bashkëpunojnë me njëra tjetrën, deri në çfarë mase ata janë të përfshira në planifikimin buxhetor, si ata i inkorporojnë nevojat e fëmijëve dhe si i shtyjnë përpara interesat e veta në këtë fushë etj. Synimi ishte që të merrnim të dhëna cilësore të cilat reflektohen në pjesën e fundit të raportit e që na kanë ndihmuar për të hartuar rekomandime specifike për nevojat e komunës së Pejës.

Vlen të përmendet se raporti është hartuar në atë mënyrë që ofron një kombinim të gjetjeve specifike komunale dhe një vështrim të indikatorëve të përgjithshëm makroekonomik e që bashkërisht e japin një pamje të qartë të situatës në terren. Raporti përfundon duke listuar gjetjet kryesore dhe liston rekomandime që janë ekskluzivisht të bazuara në informacione cilësore që ne i kemi mbledhur gjatë fazave të ndryshme të hulumtimit.

KOSOVA – PROFILI MAKROEKONOMIK

Republika e Kosovës, njëherit shteti më i ri në Evropë, është një shtet me 1.824 milion banorë³ dhe mbulon një hapësirë prej 10,908 km² në rajonin juglindor të Evropës. I etiketuar si vend me të ardhura mesatarisht të ulëta nga Banka Botërore, vendi karakterizohet nga një popullatë shumë e re me një mesatare të

3 Të dhënat demografike sipas komunave, (2011), REKOS, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

përgjithshme të moshës deri 26 vjeçare, nga të cilët 53% të këtij grupi të popullatës janë nën moshën 15 vjeçare dhe më pak se një e dhjeta e popullatës është mbi moshën 65 vjeçare.⁴

Që prej përfundimit të luftës e veçanërisht që pas shpalljes së pavarësisë, vendi është angazhuar për të implementuar një sërë masash për të ecur suksesshëm drejt zhvillimit të një ekonomie të tregut. Në këtë rrugë, sfidat ishin të shumta, duke pasur parasysh përhapjen e shkallës së papunësisë dhe niveleve të varfërisë. BPV-ja reale në vitin 2013 arriti në 5.3 miliard EUR, përderisa standardi i jetesës është rritur paksa ku BPV për kokë banori tani arrin në 2,935 EUR, që është prapë shumë më e vogël në krahasim me nivelet e BPV-së për kokë banori të vendeve të rajonit.⁵ Shkalla e lartë e papunësisë që arrin në 35.1%⁶ dhe shkalla e ultë e punësimit rreth 25.5%, kontribuojnë direkt në nivelin e varfërisë e cila shifër në fakt ka zbritur nga 45.6% në vitin 2006 në 29.7% në vitin 2011 por që ende është në nivele të larta tronditëse.⁷ Ky problem ka vazhduar si pasojë e luftës së vitit 1999 dhe ndarjes nga Jugosllavia. Si rezultat, sistemi i dobët i arsimit, mundësitë e vogla të punësimit, si dhe kushtet e rënda të punës përkthehen në shifra kaq të larta të papunësisë që është duke ndikuar tek gratë dhe të rinjtë në mënyrë disproporcionale duke paraqitur kështu pengesa serioze për mirëqenien sociale dhe zhvillimin ekonomik në vend.

Politikat fiskale të vendit janë të kufizuara nga masat e adaptuara fiskale të cilat e kanë limituar borxhin publik në 9% të BPV-së.⁸ Siç raportohet nga Banka Botërore, në vitin 2013 inflacioni arriti shkallën e 1.8%, përderisa korniza fiskale reflekton në shikim të parë tendencën e që të mbajë vendin në limitet e pranueshme të menaxhimit të politikave fiskale.⁹ Pa marrë parasysh rritjen e vazhdueshme ekonomike të Kosovës që nga viti 2008, me një mesatare vjetore prej 4.5%, Kosova mbetet njëri nga shtetet më të varfra të Evropës. Sipas Raportit të Bankës Botërore, mendohet se Kosova është njëra nga katër vendet e vetme në Evropë që kanë pasur rritje ekonomike çdo vit në periudhën e pas krizës së vitit 2009, duke pasur mesatarisht rritje prej 3.5% në mes të viteve 2009-2013.¹⁰

Përgjithësisht, këta indikatorë në kombinim vetëm na ndihmojnë që të kuptojmë që situata në vend në fakt nuk na ofron një bazë të shëndoshë për ekzistencën e një niveli të pranueshëm të mirëqenies sociale. Performancat e dobëta në drejtim të rritjes së mundësive të punësimit dhe paralelisht reduktimin e nivelit të varfërisë, janë shtytja kryesore e emigrimit të pakontrolluar në vend.

	2010	2011	2012	2013	2014
BPV REALE	4,204,300,000.00	4,594,600,000.00	4,949,900,000.00	5,232,800,000.00	
BPV NOMINALE	4,402,000,000.00	4,814,500,000.00	5,058,700,000.00	5,326,600,000.00	
BPV PËR FRYMË BANORI	2,480.00	2,672.00	2,799.00	2,935.00	
BUXHETI I KOSOVËS	1,129,509,680.00	1,414,927,737.00	1,512,647,064.00	1,591,512,602.00	1,589,324,952.00

■ Fig. 1 – Llogaritë Makroekonomike në Kosovë

Në këtë kontekst, fëmijët janë ata që goditën më rëndë nga varfëria. Duke u bazuar në një studim të UNICEF Kosova, 48.6% e fëmijëve në mes të moshës 0-19 vjeçare janë në varfëri,¹¹ ku fëmijët e kategorie të margjinalizuara, që do të thotë, fëmijët e familjeve që marrin asistencë sociale, fëmijët e prindërve të papunë, komunitetet pakicë, etj. janë më shumë të ekspozuar ndaj këtij rreziku. Në anën tjetër, fëmijët e familjeve që kanë të ardhura ku të paktën një anëtar i familjes punon, e përbëjnë 36%-shin e fëmijëve që jetojnë në varfëri në vend.¹² Në anën tjetër, nivelet e ulëta të punësimit i kanë dhënë shtyrje rritjes së

4 Profil i Republikës së Kosovës, (Kosovo Country Profile), (2014), Banka Botërore

5 Llogaritë Kombëtare, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

6 *Ibid.*

7 Raporti i Bankës Botërore, Nr. 82682-XX., (2014), Banka Botërore

8 Departamenti i Shtetit: Bilanc i Klimës investive 2014, (Department of State: 2014 Investment Climate Statement), (2014), Departamenti i Shtetit të SHBA-ve

9 Rishikim i Financava Publike në Kosovë, (2014), Banka Botërore

10 Fotografi e gjendjes në vend – Grupi i Bankës Botërore në Kosovë, (2014), Banka Botërore.

11 Varfëria e Fëmijëve në Kosovë, (2014), UNICEF.

12 *Ibid.*

ekonomisë jo formale dhe direkt e kanë rritur rëndësinë e remitancave, që përbëjnë 15% të BPV-së¹³ dhe njihen si një nga burimet kryesore të të ardhurave për familjet Kosovare.

Vendi karakterizohet me pabarazi të vazhdueshme në nivele të ndryshme. Përderisa shkalla e varfërisë është më e lartë në zonat rurale në krahasim me ato urbane, prania e pabarazisë vërehet pothuajse në çdo sektor. Sa i përket arsimimit dhe punësimit, gratë dhe pakicat përballen me disavantazhe serioze. Papunësia në mesin e grave arrin në 40%, në mesin e meshkujve 28.1%, ndërsa papunësia në mesin e të rinjve është më e larta apo rreth 55.3%.¹⁴ Krejt kjo bën që Kosova të mbetet njëri nga vendet më të varfra të rajonit me një shkallë të varfërisë prej 29.7% dhe të varfërisë ekstreme prej 10.2% siç është vlerësuar në vitin 2011.¹⁵ Gjithashtu kemi një dallim të madh në shkallën e analfabetizimit, ku 12.5 % e popullatës së gjinisë femërore është analfabete, krahasuar me 4% të popullatës të gjinisë mashkullore.¹⁶

Në një tjetër aspekt, përkundër indikatorëve të dobët ekonomik, pranisë së lartë të pabarazisë dhe nivelit të ulët të mirëqenies ekonomike, Kosova rangohet gjithashtu si njëra nga vendet që i përkasin kategorisë së vendeve me shkallë të lartë të indeksit të korrupsionit. Duke u bazuar në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit 2014,¹⁷ vendi vlerësohet me 33 pikë në një nivel prej 100 pikësh, ku niveli 0 tregon shkallën më e lartë e korrupsionit në vend.

Përfundimisht, përkundër faktit që vendi ka mundur të ecë shume përpara që nga periudha e pas luftës dhe që prej themelimit të tij si një vend i pavarur, kapacitetet institucionale për të adresuar problemet mbizotëruese janë të dobëta sikurse është edhe vullneti për ta bërë këtë. Rrjedhimisht, nevoja për iniciativa dhe përpilim të politikave me qasje nga nivelet më të ulta të politikbërjes drejt nivelit qendror shihet si zgjidhja më e mirë për adresimin e problemeve ekzistente duke marrë parasysh rrethanat në vend.

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË KOSOVË

Legjislacioni që mbulon të drejtat e fëmijëve në Kosovë e definon 'fëmiun' si një qenie njerëzore nën moshën 18 vjeçare, gjë që është në pajtim me definicionin e fëmiut që ofrohet në Konventën e KB-së për të Drejtat e Fëmijëve. Në këtë moshë, një person konsiderohet sa ka arritur maturinë, i jepet e drejta për të votuar, mund të hyjë në marrëdhënie martesore si dhe i jepen të gjitha të drejtat që i takojnë një të rrituri.

Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve është një e drejtë e caktuar përmes kornizës kushtetuese në Kosovë. Për më shumë, duke qenë vend që e ka transponuar Konventën e KB-së për të Drejtat e Fëmijëve përmes Kushtetutës, vendi ka marrë masa serioze për nga ana ligjore për të draftuar dhe dekretuar ligje që shërbejnë për interesat më të mira të të drejtave të fëmijëve, por në të njëjtën kohë, ka një numër të strategjive të ndryshme që politikbërësit në nivelin qendror kanë hartuar në mënyrë që të drejtat e fëmijëve në vend të mbrohen.

Përveç kornizës së pasur ligjore që do të elaborohet më vonë në raport, promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në Kosovë është një pikë kyçe e Strategjisë dhe planit kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë 2009-2013, Strategjisë dhe planit të veprimit për organizmin e arsimit përfshirës për fëmijët me nevoja të veçanta në arsimin para universitar në Kosovë 2010-2015, Strategjia për shëndetin e nënës, fëmiut, adoleshentit, dhe shëndetit riprodhues 2011-2015 dhe e shumë strategjive të tjera të cilat adresojnë çështjen e të drejtave të fëmijëve në këto sektore.

Përkundër faktit që Kosova ka ndërtuar një kornizë ligjore të kënaqshme, ka hartuar dhe aprovuar strategji për të drejtat e fëmijëve, si dhe, ka themeluar institucione me fokus të veçantë në këtë drejtim, problemi themelor është se veprimet e Qeverisë nuk e përçojnë të njëjtën bindje. Sidomos për shkak se për

13 Studimi për Remitancat në Kosovë 2013, (2013), Agjencia e Statistikave të Kosovës.

14 Rezultatet e Studimit të Fuqisë Punëtore, (2013), Agjencia e Statistikave të Kosovës.

15 *Ibid.*

16 Studim i Republikës së Kosovës mbi profilin e varfërisë në Rajonin e Evropës, (Republic of Kosovo Study for Poverty Profile in European Region), (2010), Japan International Cooperation Agency.

17 Sa i korruptuar është vendi yt? Indeksi i Përceptimit të Korrupsionit, (2014), Transparency International.

implementim real të këtyre strategjive dhe ligjeve dhe fuqizim të institucioneve për të bërë këtë, duhet të ketë dedikim të fondeve si dhe mbështetje të përshtatshme financiare. Megjithatë, deri më tani, përkushtimi serioz i politikbërësve në këtë drejtim ka qenë i mangët dhe për këtë arsye rezultate janë të pakënaqshme ose inekzistente sa i përket adresimit të këtyre çështjeve. Për të adresuar çështje të tilla të rëndësishme sociale dhe makroekonomike, metoda më e mirë është të fillohet të adresohet problemi nga një qasje e decentralizuar.

INVESTIMI NË FËMIJË NDIKON POZITIVISHT NË ZHVILLIMIN EKONOMIK DHE SHOQËROR

Të shpenzosh në politika të drejtuara drejt mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve është të investosh në të ardhmen e përbashkët. Investimi i burimeve financiare në drejtim të asaj që të mundësohet mbijetesa e tyre si dhe zhvillimi i potencialit të tyre është një obligim moral dhe etik për secilin nga ne. Gjithsesi, investimi në fëmijë duke krijuar kështu politika të fokusuar drejt promovimit të të drejtave të fëmijëve është profitabil për shoqërinë në tërësi. Zhvillimi i një vendi varet nga niveli i arsimit, gjendja shëndetësore, dhe mirëqenia e fëmijëve. Investimi sjellë shumë rezultate pozitive në një shoqëri, politikë dhe ekonomi. Duke pasur parasysh se një fëmijë krijon një bazë të shëndosh të gjendjes shëndetësore, edukative dhe të mirëqenies sociale në fëmijërinë e hershme, investimi në zhvillimin e tyre në këtë moshë të hershme konsiderohet si investimi më efektiv. Në anën tjetër, duke kuptuar që mungesa e investimeve në zhvillimin e fëmijëve ka efekte negative në shoqëri ne konstatojmë se kostot e mungesës së investimit i tejkalojnë kostot e investimit. Rrjedhimisht, për të evituar koston afatgjatë ne duhet të fillojmë të kontribuojmë sot dhe të investojmë në të drejtat e fëmijëve.

Pikë se pari, pika e 4 e Konventës së KB-së për të Drejtat e Fëmijëve thotë se ‘shtetet kanë obligim që të ndërmarrin masa [në drejtim të promovimit të të drejtave të fëmijëve] në shkallën maksimale të burimeve të tyre dhe, ku të ketë nevojë, në kuadër të kornizës së bashkëpunimit rajonal.’ Ky nen i obligon ligjërish të gjithë nënshkruesit e Konventës që të përdorin burimet e tyre në shkallën maksimale në mënyrë që të realizohen të drejtat ekonomike, sociale dhe politike të fëmijëve.¹⁸

Së dyti, vendet që kanë tendencë të bëhen anëtare të Bashkimit Evropian duhet të punojnë në drejtim të të drejtave të fëmijëve sepse kjo është një nga kërkesat kryesore që BE ka vënë për procesin e anëtarësimit.¹⁹ Varfëria e fëmijëve si dhe ndalimi i bartjes së varfërisë nga një gjeneratë në tjetrën është njëra ndër synimet kryesore të agjendës së Bashkimit Evropian. Problemi i varfërisë së fëmijëve konsiderohet një problem multidimensional që kërkon një intervenim urgjent.²⁰ Rrjedhimisht lind nevoja për adresimin e çështjes së varfërisë së fëmijëve për të arritur stabilitetin social dhe zhvillimin ekonomik. Pra, një vend që është në proces të anëtarësimit duhet të ketë politika që përfaqësojnë, mbrojnë dhe garantojnë të drejtat e fëmijëve.

Për më tepër, duke pasur parasysh rëndësinë e fëmijërisë, UNICEF në raportin e tij ‘Investimi në fëmijë’ thekson se “zgjedhjet e politikave që bëhen sot do të jenë përcaktuese nëse miliona fëmijë dhe të rinjtë do të arrijnë potencialin e tyre të plotë, ose do të lihen të ballafaqohen me një të ardhme ku rritet pabarazia dhe marginalizimi.”²¹

Kjo deklaratë tregon rëndësinë e investimit në fëmijë dhe efektet negative që do të ketë në shoqëri mungesa e investimit në ta. Për më shumë, ky investim nuk do t’i ndihmojë vetëm fëmijët, pasi që ky lloj investimi me efekt përhapës do të ndikoj tek të tjerët në mënyrë indirekte. Nëse fëmijët rriten në një am-

18 Rishikim i shpenzimeve publike me fokus në fëmijë (Child-focused public expenditure review), (2009), Zyra e UNICEF-it në Shkup

19 Neni 24-të i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian specifikon se fëmijët kanë të drejtë për mbrojtje dhe kujdes të nivelit të tillë që promovon plotësisht mirëqenien e tyre si dhe interesat e fëmijëve duhet të jenë në fokus primar kur kemi të bëjmë me çështje që prekin të drejtat e tyre.

20 Rishikim i shpenzimeve publike me fokus në fëmijë (Child-focused public expenditure review), (2009), Zyra e UNICEF-it në Shkup

21 Rees, Nicholas, Jingqing Chai, and David Anthony. E drejta në princip dhe në Parim: Një rishikim i kthimeve ekonomike për investimet në fëmijë, (Right in principle and in practice: a review of the social and economic return to investin in children), (2012)

bient të këndshëm edhe njerëzit e tjerë do të jetojnë më mirë. Rrjedhimisht, interesat e secilit fëmijë duhet të përfaqësohen në politikat e vendit dhe fëmijët duhet të kenë qasje të barabartë në arsimim, shëndetësi, dhe asistencë sociale. Kjo do të ishte profitabile për shtetin në aspektin ekonomik, politik dhe në aspektin social.

Pikë së pari, shëndetësia është një faktor vital që ndikon në mirëqenien e fëmijut. Rrjedhimisht investimi i burimeve në shëndetësi sjellë një sërë përfitimesh për shoqërinë. Fëmijët e shëndoshë mund të mësojnë më mirë, ata kanë aftësi më të forta fizike dhe mendore, rrjedhimisht kanë kapacitetet për produktivitet më të lartë dhe sjellin rezultate më të mira. Fëmijët e shëndoshë janë më produktiv e rrjedhimisht ata krijojnë një ambient më të shëndetshëm që është më atraktiv për investime, gjë që rrjedhimisht rezulton në përfitime ekonomike në nivel shtetëror.²²

Shpenzimi në programe dhe politika të fokusuar në të drejtat e fëmijëve të cilat kanalizojnë investimet në shëndetësi, arsim, dhe mirëqenie të fëmijëve ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të tyre dhe rrjedhimisht ngritin potencialin e tyre për prodhimtari më të lartë në shoqëri duke ndikuar kështu në rritjen ekonomike. Rritja ekonomike do të çonte në investime shtesë me shumë mundësi për krijimin e vendeve të reja të punës dhe reduktim të varfërisë.

Për më tepër, arsyeja më e rëndësishme për të mbështetur arsimimin e fëmijëve është se kur një qeveri investon në fëmijë ajo investon në kapitalin e saj njerëzor, në ardhmërinë e saj. Investimi në arsim është mënyra më e mirë për të krijuar individ të fortë dhe produktiv që do të çonin në krijimin e një kombi të fortë. Arsimitimi i shton aftësitë e punës e që ndikon në rritjen e një fuqie punëtore të pajisur mirë duke sjellë outpute më të mëdha dhe rritje ekonomike. Të gjitha këto kontribuojnë në kthime ekonomike dhe sociale duke reduktuar kostot sociale të shkaktuara nga papunësia e rrjedhimisht edhe varfërinë.

Për më tepër, investimi në fëmijë sjellë përfitime edhe për shoqërinë gjithashtu. Qeveritë mund të kontribuojnë në shoqëri duke krijuar politika që nuk i ndalojnë të rinjtë dhe fëmijët nga mundësitë e barabarta për shkollim, punësim dhe trajnime sepse kjo mund të shtyj drejt pabarazisë dhe diskriminimit në shoqëri, e që më vonë sjellë probleme të tilla si korrupsioni dhe demokracia e dështuar. Duke u bazuar në raportin e Save the Children "Investimet në Fëmijë," një shoqëri që kujdeset për fëmijët dhe është e përkushtuar që të krijoj ligje dhe rregulla nga të cilat përfitojnë fëmijët ka më shumë gjasa që të ketë stabilitet shoqëror dhe promovim të barazisë nga e cila gjë përfitojnë të gjithë qytetarët.²³

Në anën tjetër, investimi i pamjaftueshëm social, rinia e pa-arsimuar, niveli i lartë i pabarazisë dhe varfëria e ndalojnë zhvillimin e demokracisë. Si rezultat, nëse një qeveri synon të zhvilloj vendin e vet, investimi në fëmijë është mënyra më e mirë që ajo qeveri mund të shpenzoj resurset e saj.

CIKLI I PËRPILIMIT TË BUXHETIT NË NIVEL QENDROR DHE LOKAL

Hartimi dhe përgatitja e buxhetit në nivelin qendror është e rregulluar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Llogaridhënie. Duke u bazuar në këtë ligj, jo më larg se me datën 30 prill të vitit të caktuar financiar, Qeveria obligohet që t'i dorëzoj Kuvendit një Kornizë të Shpenzimeve Afatmesme, e cila përveç indikatorëve makroekonomik dhe fiskal, duhet të tregoj edhe shumën e granteve qeveritare për secilën komunë të llogaritura në pajtim me formulën e dhënë në Ligjin për Financimin e Pushtetit Lokal. Gjithashtu, Ministria e Financave duhet të lëshoj qarqet buxhetore të organizatave buxhetore jo më larg se data 30 prill e vitit fiskal, që specifikon tavanin e granteve dhe ofron instruksione që duhen ndjekur gjatë përgatitjes së Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Komunat, në anën tjetër, duhet të dorëzojnë buxhetin

22 Investimi në Fëmijë: Një shikim i shkurtër i kthimeve ekonomike dhe sociale të investimit në fëmijë, (Investing in Children: A brief overview of the social and economic returns to investing in children), (2014), UNICEF.

23 Perezniato, Paola, Anamaria Golemac Powell, dhe Merima Avdagic., Investimi në fëmijë, (Investment in Children), (2011), Overseas Development Institute.

e propozuar dhe kërkesat për ndarje buxhetore deri më 30 shtator të atij viti. Ministri nuk ka të drejtë për të ndryshuar buxhetin përveç nëse komunat nuk i janë përshtatur procedurave të dhëna. Në momentin kur Buxheti i Konsoliduar i Kosovës miratohet nga Qeveria, ai duhet të dorëzohet në Kuvend jo më larg se me datë 31 tetor të vitit të atëhershëm fiskal. Përfundimisht, Kuvendi e miraton buxhetin në fund të muajit dhjetor, që njëherit shënon fundin e vitit fiskal.²⁴

Përderisa, lidhur me përgatitjen e buxhetit në nivelin lokal, që është më relevante për fushën e studimit tonë, procesi rregullohet nga po i njëjti Ligj për Menaxhimin e Financave Publike si dhe Llogaridhënies si dhe Ligji mbi Financimin e Qeverive Lokale. Pasi ta pranojnë qarkoren e buxhetit nga ministria, Zyrta Kryesor Financiar në nivelin komunal duhet t'ua dorëzojë qarkoren e buxhetit secilit kryesues të departamenteve të ndryshme në kuadër të Komunës para ose më së largu me datë 1 korrik të vitit fiskal. Pas skadimit të datës për dorëzimin e qarkores dhe pas marrjes së propozimeve buxhetore nga departamentet, ZKF është i detyruar që t'i rishikoj buxhetet e dorëzuara. Pas konsultimit me departamentet dhe hartimit të një forme përfundimtare të buxhetit, ZKF duhet t'ia dorëzojë buxhetin kryetarit të Komunës. Pas kësaj kryetari duhet ta dorëzojë buxhetin tek Kuvendi Komunal deri më 1 shtator. Pas kësaj komunat detyrohen të mbajnë dëgjime publike dhe obligohen që të dorëzojnë buxhetin përfundimtar deri më datë 30 shtator.²⁵

ANALIZË E BUXHETIT KOMUNAL

Pjesa vijuese e raportit prezanton një analizë financiare të trendëve buxhetore në nivelin qendror dhe në Komunën e Pejës. Analiza është e përqendruar në tri sektorë të ndryshme por që ndërlidhen me njëra tjetrën e që direkt ndikojnë në mirëqenien e fëmijëve në Kosovë dhe në këtë komunë. Me fokus në shëndetësi, arsimim dhe shërbime sociale, kjo pjesë ofron një vështrim të mostrave të shpenzimeve në pesë vitet e fundit, analizën e profilit të vijave buxhetore, duke listuar çështjet dhe fushat kryesore të cilat kërkojnë intervenim.

NJË PROFIL I KOMUNËS SË PEJËS

Peja, duke qenë qyteti i dytë më i madh në Kosovë mbulon një territor prej 602 km² me 95 fshatra.²⁶ Komuna e Pejës ndodhet në pjesën perëndimore të Republikës së Kosovës. Në Pejë jetojnë 96,450 qytetarë me një shpërndarje pothuajse të barabartë të popullsisë mes pjesës urbane dhe asaj rurale.²⁷ Vlerësohet se 58% e popullatës jeton në zonat urbane, ndërsa 42% jeton në zonat rurale. Struktura e moshës në komunë është si në vijim: 1,568 janë foshnje, apo 1.6% e popullatës; 30,165 ose 31.3% janë prej moshës 1-18 vjeçare; 57,223 ose 59.3% janë 19-64 vjeç; ndërsa 7,494 janë mbi 64 vjeç.²⁸ Përderisa vlerësimi për strukturën etnike tregon se 87,975 janë shqiptar, me çka kuptojmë që ata e përbëjnë shumicën e popullsisë, 332 janë serb kosovar, 3,786 janë boshnjak, 3,836 janë nga komuniteti RAE, dhe pjesa tjetër i përket grupeve të tjera etnike.²⁹

Komunës së Pejës i është alokuar një buxhet prej 19.2 milion EUR për vitin fiskal 1 Janar – 31 dhjetor 2014, përderisa buxheti i parashikuar për vitin 2015 pritet të rritet për një margjinë 9.8%, duke arritur kështu në 21.1 milion EUR.³⁰ Sipas shpërndarjes, 54.92% janë të alokuara për pagat dhe mëditjet, 12.69% janë për mallra dhe shërbime, 3.19% për shërbime komunale, 1.82% subvencione dhe transfere, dhe pjesa

24 Ligji Nr. 03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Llogaridhënies. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

25 Ligji Nr. 03/L-049 mbi Financimin e Pushtetit Lokal, Kuvendi i Kosovës.

26 Komuna e Pejës, Profili, Komuna e Pejës (Web).

27 Bazuar në censusin e vitit 2011, 48,962 banorëve jetonin në zonën urbane të komunës, përderisa 47,488 qytetar jetonin në zonat rurale.

28 Të dhënat demografike sipas komunave, (2011), Agjencia Kosovare e Statistikave.

29 *Ibid.*

30 Buxheti i Komunës së Pejës 2014, Komuna e Pejës, Departamenti i Financave,

e mbetur prej 27.38% janë të destinuar për investime kapitale.³¹ Koncentrimi i pjesës më të madhe të buxhetit në paga dhe mëditje është një fenomen prezent në të gjithë vendin, përderisa rritja e zakonshme në buxhetin e alokuar për një komunë, në këtë rast të Pejës, i atribuohet saktësisht buxhetimit më të lartë në këtë vijë buxhetore.

Duke u fokusuar në buxhetin e alokuar në sektorët e veçantë që bijnë në fushën e studimit tonë, Komuna e Pejës ka alokuar 2.5 milion EUR apo 13% të buxhetit komunal për shërbime shëndetësore dhe sociale, nga e cila shumë, 97% ka shkuar për sektorin e shëndetësisë ndërsa pjesa e mbetur ka shkuar për sektorin e shërbimeve sociale. Përderisa në përgjithësi, si në nivelin e vendit ashtu edhe në atë komunal, statistikatat për mirëqenien sociale tregojnë një gjendje shumë të pakënaqshme, ku buxheti i alokuar për ofrimin e shërbimeve sociale dhe asistencës nuk ka shënuar ndonjë progres për sa i përket rritjes së buxhetit për këtë kategori. Përafërsisht 44% e buxhetit alokohet për zhvillimin e sektorit të arsimit, ose më konkretisht 8.4 milion EUR, përderisa jo më shumë se 3.2% e buxhetit, ose 187,800 EUR janë të alokuara për zhvillimin e kulturës dhe sportit.

Sa i përket aktivitetit ekonomik, qyteti varet dhe është historikisht i njohur për traditën e tij në bujqësi dhe punimet zejtare të cilat punohen në mënyrë mjeshtrërore nga zejtarët lokal. Bujqësia është një faktor i madh që ndikon në ekonomi, duke pasur parasysh tokat e pasura bujqësore që mbulojnë rreth 51.74% të hapësirës në komunë, prej të cilave rreth 67.5% janë të kultivuara. Për më shumë, një përparësi e qytetit të Pejës janë pasuritë e tija atraktive turistike siç janë Gryka e Rugovës, Bjeshkët e Nemuna dhe Banja e Pejës.³² Peja ka potencial të madh për zhvillimin e turizmit malor, për këtë ka qenë dhe mbetet vend mjaft atraktiv për investitorët e brendshëm dhe të huaj. Në prill të vitit 2008, në Pejë kanë qenë të regjistruara 4,137 biznese te vogla, 80% e tyre kanë qenë të koncentruara në sektorin e tregtisë.³³ Megjithatë numri i të papunëve në komunë është drastikisht i lartë. Në vitin 2011, duke u bazuar në raportin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, raportohet se 34,708 qytetar janë të regjistruar si të papunë, e që në përqindje del se është 35.9% e popullsisë që nuk punon.³⁴

Duke pasur parasysh nivelin e lartë të papunësisë në komunë, brengat e qytetarëve janë të fokusuar në këtë drejtim e gjithashtu edhe politikatat e politik bërësve. Përderisa është e vërtetë se përmirësimi i niveleve të punësimit dhe performanca e të gjithë indikatorëve ekonomik ndikon në mirëqenien e fëmijëve, promovimi i të drejtave të fëmijëve është gati i padukshëm në agjendën lokale. Për më shumë, ka një mungesë të vetëdijes për të kuptuar rëndësinë e investimit në mirëqenie të fëmijëve. Përderisa një analizë e thellë e secilit prej sektorëve të përzgjedhur të interesit tonë do të pasoj në pjesën tjetër të këtij raporti, vlen të përmendet se Komuna e Pejës, sa i përket promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, është ndihmuar shumë nga Save the Children, UNDP, UNICEF, përderisa shumë iniciativa janë udhëhequr nga organizatat lokale si OJQ Syri i Vizionit dhe Iniciativa 6.

VËSHTRIM MBI FINANÇIMIN E QEVERISJES LOKALE

Kushtetuta së bashku me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale i ka deleguar një numër të kompetencave nga niveli qendror në atë lokal, rrjedhimisht ka rritur numrin e përgjegjësive të komunave të Republikës së Kosovës. Përveç një numri të madh të detyrave dhe obligimeve, komunat kanë përgjegjësinë për menaxhimin dhe implementimin e politikave në fushën e shëndetësisë primare, arsimin para universitar, si dhe ofrimin e shërbimeve sociale.³⁵

31 Buxheti i Komunës së Pejës, Departamenti i Financave në Komunën e Pejës.

32 Rreth Pejës. Klubi Rotarian në Pejë.

33 Ekonomia. Komuna e Pejës (Web.).

34 Puna dhe Punesimi- Raporti Vjetor 2011, (2011), Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

35 Ligji Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale. Kuvendi i Kosovës.

Ideja e delegimit të fuqisë dhe sistemit të decentralizuar të ofrimit të shërbimeve sociale shihet si një mundësi për t'i ofruar qytetarëve një shans më të mirë për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe politikbërje duke rritur kështu llogaridhënien e politik bërësve ndaj qytetarëve.

Në mënyrë që të kuptojmë implikimet e decentralizimit, bazën e tij dhe më pas implemtimin e tij në praktikë në fushën e tre sektorëve të përzgjedhur, ne fillimisht do të shpjegojmë bazën ligjore e cila qartë definon obligimet e komunave në lidhje me menaxhimin e financave të tyre.

Në këtë aspekt, ka një rregull specifik për hartimin e buxheteve komunale si dhe mënyrat se si niveli qendror e përkrah nivelin lokal në aspektin e mbështetjes financiare. Mbështetja financiare për implemtimin dhe kryerjen me sukses të këtyre kompetencave të deleguara kryhet përmes lëshuarjes së tre granteve kryesore: granti i përgjithshëm dhe grantet specifike për arsim dhe shëndetësi.³⁶ Komunitat megjithatë kanë pjesën e tyre të kontributit në lidhje me këtë. Buxheti i komunave duhet të përbëhet nga të hyrat vetanake, grantet qeveritare dhe donacionet dhe burimet tjera të të ardhurave. Përgjithësisht, pjesa më e madhe e buxhetit të komunave në secilën vijë buxhetore përbëhet nga grantet qeveritare, ku komunitat tentojnë të ndihmojnë përmes të ardhurave vetanake, të cilat janë zakonisht shumë të vogla.

Në lidhje me grantet e përgjithshme dhe dy grantet specifike, është me rëndësi të cekim mënyrën se si këto grante kalkulohehen dhe alokohen horizontalisht mes komunave të ndryshme. Për kalkulimin e grantit të përgjithshëm, Neni 24 i Ligjit të Financimit të Pushtetit Lokal ofron qartë kritere strikte që duhen respektuar gjatë kalkulimit kur vendoset për shpërndarjen e granteve në mes të komunave e që bazohet në numrin e popullsisë, numri i popullsisë pakicë, hapësira fizike, etj. Në anën tjetër, grantet specifike janë të dizajnuara të garantojnë nivelin minimal të standardeve të shërbimeve në arsimin para universitar dhe në kujdesin primar shëndetësor në nivelin lokal, dhe kalkulohehen nga një formulë strikte që ofrohet nga Komisioni i Granteve.³⁷

Ideja për të pasur një grant të veçantë për arsim dhe shëndetësi mbështetet fuqishëm dhe përfundimisht shihet si një alternativë e mirë për t'ju qasur financimit të sektorit të mbrojtjes sociale në vend. Sipas Mentor Morinës, Udhëheqës i Departamentit për Planifikim dhe Përfshirje Sociale në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kjo ministri në gjysmën e parë të këtij viti ka dorëzuar një kërkesë tek Ministria e Financave që të rishikoj mundësinë e krijimit të grantit specifik për shërbime sociale në mënyrë që të sigurohet standardi minimal i shërbimeve të ofruara në nivelin lokal. Kjo kërkesë për grantin specifik ka qenë gjithashtu ndër gjetjet dhe theksimet më të mëdha të publikimit të fundit të KOMF³⁸ e që ka marrë mbështetje të gjerë nga publiku. Arsye të një grant specifik në këtë sektor është i nevojshëm në këtë stad të zhvillimit të vendit do të elaborohen më vonë në këtë raport.

Pasi që shumica e granteve nga Qeveria është qartësisht e definuar, është shumë me rëndësi të shikohen mundësitë e zgjerimit të bazës financiare si dhe të bëhet identifikimi i kombinimeve të mundshme për të rritur shumën e fondeve që do të mund të alokoheshin specifikisht për financimin e projekteve që kanë për qëllim promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Siç parashihet në Ligjin për Financim të Pushtetit Lokal, përveç taksave në pronë të paluhatsëm komunitat nuk lejohen të prezantojnë taksat të reja nën kompetencat e tyre. Të ardhurat vetanake në anën tjetër përbëhen prej taksave komunale si dhe pagesave për shërbime publike, qiraja nga pronat e paluhatshme, shitja e pronave të komunës, pagesat e qytetarëve për shërbime mjekësore dhe edukative, interesi në depozitat e komunës si dhe grantet nga qeveritë e jashtme. Secili burim tjetër i të ardhurave mund të rregullohet vetëm me dispozitë ligjore. Po ashtu, komunitat mbledhin të ardhura shtesë nga pagesat që bëhen për parkim në qytet, përdorimi i hapësirave të komunës për veprimtari rekreative, pagesat që bëhen për peshkim apo gjueti në komunë, etj. Në mënyrë që të kuptojmë implikimet e menaxhimit momental të fondeve publike komunale, pjesët në vazhdim do të ofrojnë një analizë të ndarë për secilin sektor të përzgjedhur në Komunitat e Pejës, duke nxjerrë konkludime dhe duke listuar rekomandime në bazë të të gjeturave.

36 Ligji Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale. Kuvendi i Kosovës.

37 *Ibid.*

38 A po arrijnë tek fëmijët në nevojë paratë e taksapagueseve? Prill 2014. Koalicioni I OJQ-ve për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë (KOMF).

ANALIZË E SEKTORIT TË SHËNDETËSISË NË KOSOVË

Mirëqenia e fëmijëve varet shumë nga shëndeti i tyre. Megjithatë, sistemi shëndetësor në Kosovë kritikohet shumë për dështimin e tij për t'i përmbushur kërkesat e qytetarëve. Që nga përfundimi i luftës, shëndetësia në Kosovë ka hasur në shumë vështirësi, që përfundimisht kanë pasur ndikim tek qytetarët e saj. Synimi i Qeverisë për periudhën 2010-2014 ka qenë që "të zhvilloj një sistem të qëndrueshëm shëndetësor për të gjithë qytetarët me synim arritjen e standardeve Europiane, ku mjekësia familjare është gurthemel i kujdesit primar shëndetësor."³⁹

Përkundër përkushtimit të Qeverisë që të garantoj kualitet më të lartë të shërbimeve mjekësore si dhe një sistem më të drejtë për të gjithë, statistikave në vend nuk tregojnë ndonjë përparim të dukshëm. Sipas UNICEF-it në Kosovë, theksohet se shkalla e vdekshmërisë së foshnjave në vend është më e larta në Evropë, përdorisa 1 në 3 fëmijë vuan nga mungesa e vitaminës A dhe deri në 5% të fëmijëve në Kosovë nuk ushqehen mirë. Gjetjet sugjerojnë se shkaqet kryesore që shkaktojnë vdekshmërinë e foshnjave janë sëmundjet e frymëmarrjes, diarreja, si dhe sëmundjet prinatale (para lindjes), etj.⁴⁰ Gjithashtu edhe shkalla e vdekjes së nënave është mjaft e lartë. Në vitin 2011 ishte evidentuar se kishte një shkallë të vdekshmërisë prinatale prej 18.7%, vdekshmëria e fetuseve ishte 11%, përdorisa vdekshmëria neonatale ishte 7.5%. Për më tepër, vdekshmëria e foshnjave në Kosovë në vitin 2011 ishte 20.5%.⁴¹

Këto statistika tregojnë se ka nevojë të menjëhershme për aktivizim shoqëror dhe koordinim ndërmjet politik bërësve për të adresuar çështjet dhe problemet që janë të natyrës serioze dhe në mënyrë të drejt-përdrejtë e pengojnë mirëqenien e shoqërisë. Përdorisa vdekshmëria e foshnjave mbetet e lartë, Kosova mbetet ndër vendet me natalitetin më të lartë, me një mesatare prej 35,000 fëmijëve të lindur çdo vit.⁴² Megjithatë, në shkallën e përgjithshme, vendi ka përparuar në rritjen e nivelit të qasjes në imunizim, por që prap paraqet një problem për komunitetin RAE sepse imunizimi në këtë komunitet mbetet i ulët.

Në mungesë të një sistemi të sigurimeve shëndetësore, Parlamenti në prill të vitit të kaluar miratoi Ligjin mbi Sigurimet Shëndetësore. Ligji për sigurimin shëndetësor pritet të bëhet plotësisht funksional në fillim të vitit të ardhshëm dhe besohet se do të garantoj qasje universale për qytetarët e Kosovës në kujdesin bazik mjekësor përmes reduktimit të kostos së kujdesit mjekësor që pritet që specifkisht t'ju përmirësoj qasjen në shërbime mjekësore kategorive më të varfra në vend. Me rregullimin e sistemit të sigurimit shëndetësor, pritet që të rritet edhe kualiteti i ofrimit të kujdesit primar mjekësor në vend. Për më shumë, Neni 7.1.2 i ligjit përcakton se shërbimi primar mjekësor nga lista e shërbimeve bazike shëndetësore do t'iu ofrohet fëmijëve nën moshën 18 vjeçare pa marrë parasysh statusin e tyre të sigurimit. Kjo pritet të kontribuoj direkt në mirëqenien e fëmijëve në vend.⁴³

Përfundimisht, në fushën e shëndetësisë, një çështje me rëndësi është mungesa e të dhënave statistiko-re që do të ndihmonin në matjen e trendëve brenda sektorit të shëndetësisë, të kuptohet progresi/regresi i bërë dhe kështu të mundësohej hartimi politikave që u përgjigjen nevojave të qytetarëve. Përdorisa Agjencia e Statistikave të Kosovës prodhon raporte të rregullta mbi statusin shëndetësor të qytetarëve në vend, nuk ka statistika të detajuara që do të ofronin informacione specifike rreth gjendjes shëndetësore të fëmijëve, e lëre më statistika specifike në kuadër të komunave, që do të ndihmonin autoritetet lokale për të hartuar politika duke u bazuar në nevojat e qytetarëve të tyre.

39 Strategjia e Sektorit të Shëndetësisë 2010-2014. (2010), Ministria e Shëndetësisë.

40 Fëmijët, Vitet e hershme, UNICEF Kosova.ë

41 Azemi, M., Gashi, S., Berisha, M., Kolgeci, S., & Ismaili-Jaha, V., Shkalla dhe Trendet Kohore të Mortalitet Perinatal, Foshnjor, dhe Maternitar, Nataliteti dhe Shtimi Natyral i Popullatës në Kosovë, (2012), US National Library of Medicine

42 Fëmijët, Vitet e hershme, UNICEF Kosova

43 Ligji Nr. 04/L-249 mbi Sigurimet Shëndetësore. Kuvendi i Kosovës.

BAZA LIGJORE PËR SHËNDETËSI

E drejta e fëmijëve për kujdes shëndetësor kualitativ, jo diskriminues, dhe efektiv garantohet me këto ligje: Ligji i Shëndetësisë; Ligji mbi Përfundimin e Shtatzënisë; Ligji mbi të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdes Mjekësor; Ligji për Nxitjen dhe Mbrojtjen e Dhënies së Gjirit; Ligji mbi Shëndetin Riprodhues, Ligji për Drogat Narkotike, Substancat Psikoterapike Paraprake; Ligji mbi Inspektoratin Shëndetësor, dhe Ligji për Sigurim Shëndetësor.

Duke u bazuar në përmbajtjen e këtyre ligjeve, qëllimi është që t'ju ofrohen fëmijëve shërbime mjekësore që do t'i plotësonin standardet ndërkombëtare të kualitetit dhe do të siguronin qasje të barabartë për të gjithë, duke respektuar dinjitetin e tyre dhe që do të ishin në përputhshmëri të plotë me nevojat e tyre.

Në përgjithësi, ashtu siç ceket në Ligjin e Shëndetësisë, sistemi shëndetësor në Kosovë është i organizuar në tri sektorë, kujdesi primar, sekondar dhe kujdesi terciar mjekësor.⁴⁴ Përderisa ndërtesat e shërbimit mjekësor terciar janë të lokalizuara në kryeqytet, shërbimi shëndetësor primar dhe sekondar është i organizuar në mënyrë të decentralizuar dhe si i tillë ofrohet në qendrat e mjekësisë familjare dhe njërive ambulatorore dhe spitaleve rajonale respektivisht.

Sa i përket financimit të buxhetit të shëndetësisë, duke u bazuar në Nenin 3 të Ligjit të Shëndetësisë, resurset për sektorin e shëndetësisë duhet të ofrohen nëpërmes një kombinim të Buxhetit të Kosovës, Buxhetit Komunal, ku nuk përjashtohen bashkë pagesat e shfrytëzuesve të sistemit të shëndetësisë në pajtim me këtë ligj, dhuratat dhe trashëgimitë nga qytetar individual, donacione në kesh ose të ngjashme, të ardhurat nga aktivitetet të autorizuara, institucionet lokale dhe të huaja (private ose publike) të sigurimit shëndetësor, pagesat direkte të përdoruesve të shërbimeve të sigurimit shëndetësor, qofshin ata lokale ose të huaja, private ose publike.⁴⁵ Shërbimet bazike mjekësore janë parashikuar të ofrohen pa pagesë për qytetarët e vendit. Si rrjedhojë, Ministria e Shëndetësisë përmes një komisioni special përgatit një listë të shërbimeve në pajtim me nevojat e qytetarëve dhe në përputhshmëri me mjetet financiare të disponueshme. Shërbimet shesë ofrohen në këmbim të pagesave nga ana e qytetarëve ose premiumeve, të cilat tani rregullohen me Ligjin për Sigurim Shëndetësor. Përfundimisht, Ministria e Shëndetësisë me propozim të Asamblesë Komunale miraton planin operativ për zhvillimin e kujdesit primar shëndetësor, në pajtueshmëri me planin afatmesëm të miratuar nga Qeveria.

Kujdesi primar shëndetësor është me rëndësi të veçantë për studimin tonë sepse planifikohet të ofroj një numër të madh të shërbimeve shëndetësore dhe preventive më çmim të përballueshme për të gjitha komunitetet në mënyrë të barabartë. Kostot e shërbimeve janë pjesërisht të mbuluara nga Qeveria përmes grantit për shëndetësinë, i cili u alokohet komunave si dhe me bashkë financim nga komuniteti. Momentalisht, qendrat e mjekësisë familjare janë duke pasur mungesë të mjekëve familjar. Përderisa statistikat e fundit tregojnë që janë 500 mjek familjar që operojnë në vend, vlerësimi pilot tregon se duke u bazuar në nevojat momentale të banorëve, ka nevojë për se paku dyfishin e këtij numri të mjekëve në mënyrë që të ofrohet shërbimi primar (preventiv) i kujdesit mjekësor në mënyrë profesionale dhe të barabartë për të gjithë qytetarët e vendit.⁴⁶

Sa i përket sistemit sekondar të kujdesit mjekësor, momentalisht janë 7 spitale rajonale në Kosovë, ku njëri prej tyre është i lokalizuar në Pejë.⁴⁷ Spitalet rajonale duhet të jenë të pajisura me specialistë dhe të jenë në mundësi të ofrojnë shërbime më të avancuara në mënyrë që të trajtojnë pacientë të cilët janë referuar për një trajtim më të specializuar nga sistemi primar i kujdesit shëndetësor.

44 Ligji No.04/L-125 mbi Shëndetësinë, Kuvendi i Kosovës.

45 *Ibid.*

46 Mungesë e specialistëve të mjekësisë familjare, (2013), Radio Evropa e Lire.

47 Statistikat e Shëndetësisë 2010, (2010), Agjencial e Statistikave të Kosovës.

SHPENZIMET PËR KUJDESIN MJEKËSOR NË KOSOVË

Në vitet e fundit ka pasur një trend të rritjes së shpenzimeve në sektorin e shëndetësisë, që do të thotë se një sasi më e madhe e fondeve është alokuar për këtë sektor. Kjo rritje e mbështetjes financiare për shërbime mjekësore pritet të shpie drejt përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë së shërbimeve preventive mjekësore, mirëpo, në fakt, ndryshimet duhet të shoqërohen me planifikim më të mirë buxhetor dhe veprime më të mira monitoruese drejt një alokimi më efektiv dhe përdorim më efikas të burimeve financiare. Kjo praktikë është specifikisht e theksuar në nivelin lokal, ku alokimi i buxhetit nuk është i bazuar në nevoja të qytetarëve dhe për më tepër mekanizmat e monitorimit dhe kontrollit nuk janë të vendosura.

Ministria e Shëndetësisë është autoriteti më i lartë në sektorin e shëndetësisë në vend. Kosova alokon një shumë prej 114 milion EUR për sektorin e shëndetësisë nga buxheti i saj i konsoliduar, që përbën 7.22% të buxhetit total në vitin 2014. Si përqindje e BPV-së, buxheti i Kosovës për shëndetësi në vitin 2013 ishte 2.05% e BPV-së. Alokimet buxhetore në sektorin e shëndetësisë shënojnë një trend në rritje nga viti ynë bazë 2010, kur buxheti i alokuar për shëndetësi ishte 70 milion EUR. Duke e krahasuar me buxhetin e vitit 2010, buxheti i tanishëm është 62% më i lartë.




Fig. 2- Buxheti i Kosovës dhe Buxheti për Shëndetësi për vitet 2010-2014⁴⁸

Vlen të përmendet fakti që sa i përket alokimit të buxhetit për shëndetësi si përqindje e BPV-së, kjo performancë është larg nga mesatarja e vendeve të OECD të cilët mesatarisht alokuan 9.1% të BPV-së në vitin 2012. Studime të ndryshme gjithashtu tregojnë që kjo shifër është gjithashtu larg performancës së vendeve të rajonit. Duke u bazuar në të dhënat e Bankës Botërore, shpenzimet e Shqipërisë për shëndetësi arritën në 6% të BPV-së, 9.9% në Bosnjë dhe Hercegovinë, 7.6% në Mal të Zi, 7.1% në Maqedoni, dhe 10.5% në Serbi.⁴⁹ Përderisa përqindja e buxhetit për shëndetësi përkrah BPV është rritur gjatë viteve me një ritëm stabil, përqindja e shpenzimeve për kujdes shëndetësor në krahasim me totalin e buxhetit të konsoliduar ka pasur trende të rënies, përveç këtij viti, ku e vërejmë se pjesëmarrja e shëndetësisë në shpenzimet e përgjithshme është rreth 7.22%.

Në anën tjetër, dallim i madh në aspektin e shumave e financiare të alokuara për këtë sektor shihet në mes të viteve 2012 dhe 2013, ku buxheti për sektorin e shëndetësisë është rritur për 19 milion EUR. Përderisa kjo mund të shihet si trend pozitiv dhe një përkushtim serioz i Qeverisë për të ndihmuar sektorin

48 Buxheti i Konsoliduar i Republikës së Kosovës 2010-2014.

49 Shpenzime shëndetësore, total (% of GDP), (2013), Banka Botërore.

e shëndetësisë, analiza më tutje do të elaboroj nëse trendët e njëjta aplikohen në lidhje me investimet në kujdesin primar shëndetësor e që është nën menaxhimin e autoriteteve lokale komunale.

Në një vështrim të përgjithshëm, përderisa buxheti i alokuar për Ministrinë e Shëndetësisë ka pësuar trende rritëse, ne mund të konstatojmë, edhe pse jo me siguri të plotë, që ka një përkushtim më të madh për rritjen e kualitetit të shërbimeve dhe performancës të këtij sektori. Megjithatë, mangësia më e madhe e këtij buxheti është mungesa e programeve të inkuorporuara vertikale. Për shembull, në linjë me Strategjinë për integrimin e komunitetit RAE në programe imunizuese, që është identifikuar si komuniteti me qasjen më të vogël në imunizim dhe shërbimet primare shëndetësore, Qeveria mund të dizajnoj programe që garantojnë integrimin e tyre në vijë me planin e veprimit të kësaj strategjie. Menaxhimi financiar i këtij programi mund të inkuorporohet në Kodin Buxhetor të Ministrisë së Shëndetësisë si një nën kod i veçantë. Dizajnimi i programeve vertikale shihet si mënyre ideale për t’ju qasur problemeve ekzistente në mënyrë direkte. Për më shumë, programe të tilla do të mundësonin përcjelljen dhe monitorimin e shpenzimeve publike, si dhe do të mundësonin që programet shëndetësore për fëmijë të shndërroheshin në prioritet në nivel vendor..

SHPENZIMET PËR SHËNDETËSI NË KOMUNËN E PEJËS

Në nivelin komunal, buxheti për shërbimet shëndetësore alokohet në një kod të përbashkët buxhetor dhe të drejtën për ta shpenzuar e ka Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Momentalisht drejtoria absorbon gati 14% të buxhetit total të Pejës, prej të cilave 12.3 % alokohen për shpenzime në fushën e kujdesit primar shëndetësor. Në shikim të parë mund të konsiderojmë se ka trende rritëse në alokimin e buxhetit për shërbime primare, mirëpo, paralelisht mund të vërejmë se këto trende janë duke u rritur me një shkallë zbrëtëse. Fillimisht kjo mund të shihet si çështje shqetësuese, por shifrat në vijim sugjerojnë se situata në fakt mund të jetë optimiste. Në terma të përgjithshëm, pjesa e përqindjes së shpenzimeve për kujdesin primar shëndetësor shënjon një trend rritës dhe në vitin 2014 shënjon kulmin e koncentrimin të fondeve për 5 vitet e kaluara. Në këtë aspekt, përderisa në vitin 2010 buxheti i alokuar për shpenzime të mjekësisë primare arriti 11.98% të buxhetit total, në vitin 2014 ai arrin 12.31% të buxhetit të përgjithshëm.




Fig. 3 – Buxheti Komunal i Pejës, buxheti për DSHMS dhe buxheti i Kujdesit Primar Mjekësor për periudhën 2010-2014⁵⁰

Për të kuptuar arsyen pas rritjes së vijës buxhetore për ofrimin e shërbimit primar mjekësor dhe për mbulimin e shpenzimeve në këtë sektor, tabela në vazhdim e jep një pamje të qartë të trendëve në periudhën 2010-2014 në aspektin se ku dhe për çfarë është përdorur buxheti në këtë sektor.

50 Buxheti i Komunës së Pejës 2010-2014, Departamenti i Financave, Komuna e Pejës




Fig.4 – Ndarja e buxhetit komunal sipas kategorive buxhetore në Komunën e Pejës

Siç është tendenca në të gjitha vijat buxhetore, koncentrimi më i madh i buxhetit është në kategorinë e pagave dhe mëditjeve. Njëra nga arsytet pas këtij fenomeni është gjithashtu vendimi i marsit 2014 i Qeverisë së kaluar për të rritur pagat e zyrtarëve publik.⁵¹ Kjo politikë në fakt ka ndikuar në shumë vija të tjera buxhetore dhe si e tillë ngritja e shumës së alokuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve shkon në dëm të një buxheti më të vogël për investime kapitale ose ofrimin e shërbimeve të ndryshme për të përmirësuar performancën e ofruesve të kujdesit primar mjekësor. Në këtë aspekt, nuk mund të mos e vërejmë se alokimi i fondeve për investime kapitale ka qenë gati i një natyre indiferente. Përderisa historikisht ka pasur performancë të dobët në shfrytëzimin e fondeve të alokuara për investime kapitale në sektorin e shëndetësisë, viti 2013 shënoi një shkallë të plotë të performancës buxhetore në këtë kategori, ku paratë u përdorën për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe renovimin e ndërtesave të reja dhe atyre ekzistuese. Në anën tjetër, niveli i shpenzimeve në kategorinë e të mirave dhe shërbimeve pason menjëherë pas shumës së shpenzimeve në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, dhe ka pësuar një rritje enorme në alokimin e fondeve. Përkundër faktit që shërbimet e trajnimeve dhe të arsimit bijnë pikërisht në këtë kategori, për shkak të etiketimit të përgjithshëm dhe jo specifik të kategorive buxhetore në raportin e shpenzimeve, ne nuk mund të identifikojmë nëse paratë në çfarëdo përqindje kanë shkuar në trajnime dhe arsimit të personelit mjekësor apo për qëllime tjera.

Në këtë aspekt, është interesant të evidentohet performanca e ekzekutimit të buxhetit brenda këtij sektori në Komunën e Pejës. Siç mund të shihet nga tabela më poshtë, e vetmja kategori që nuk ka pasur performancë të mirë në vite 2010 dhe 2012 ka qenë ajo e investimeve kapitale.

Megjithatë, performanca është përmirësuar dukshëm në vitin e kaluar dhe ka arritur nivelin e plotë të ekzekutimit buxhetor në 100%. Rikujtojmë që investimet kapitale janë përdorur për mirëmbajtjen, renovimin ose ndërtimin e objekteve të reja ose atyre ekzistuese shëndetësore. Kjo është me rëndësi të ceket sepse nuk ka pasur alokim të fondeve drejt investimeve për blerjen e pajisjeve të reja mjekësore që në një mënyrë ose tjetër do të kontribuonin në prezantimin e masave të reja për parandalimin e problemeve shëndetësore të rasteve më të rënda në komunë.

51 Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi vendimin që t'i rris pagat për të gjitha kategoritë e shërbyesve publik, përfutuesit e skemave sociale dhe pensionerëve, (2014), Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit.

CATEGORY	2010			2011			2012			2013		
	PLANIFIKU-ARA	EKZEKUTU-ARA	%	PLANIFIKU-ARA	EKZEKUTU-ARA	%	PLANIFIKU-ARA	EKZEKUTU-ARA	%	PLANIFIKU-ARA	EKZEKUTU-ARA	%
PAGAT DHE MËDITJET	1,512,990.52	1,512,754.94	99.98%	1,736,639.00	1,729,106.08	99.57%	1,776,033.90	1,775,791.93	99.99%	1,793,256.47	1,778,245.53	99.16%
MALLRA DHE SHËRBIMET	220,258.92	212,998.31	96.70%	223,178.29	223,037.93	99.94%	434,422.00	434,159.16	99.94%	468,600.00	468,573.74	99.99%
SHPENZIMET KOMUNALE	104,675.00	104,617.63	99.95%	100,000.00	99,991.21	99.99%	99,660.00	99,649.77	99.99%	102,214.00	102,156.89	99.94%
TRANSFERET DHE SUB-VENCIONET	-	-	-	-	-	-	-	-	0.00%	-	-	0.00%
SHPENZIMET KAPITALE	250,000.00	193,117.07	77.25%	-	-	-	80,754.83	69,891.36	86.55%	111,018.24	111,018.24	100.00%
TOTAL	2,087,924.44	2,023,487.95	96.91%	2,059,817.29	2,052,135.22	99.63%	2,390,870.73	2,379,492.22	99.52%	2,475,088.71	2,459,994.40	99.39%

Fig. 5 – Dallimi mes buxhetit të planifikuar dhe atij të ekzekutuara në Komunën e Pejës

MJEKËSIA PRIMARE NË PEJË – ANALIZË E GJENDJES

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, kujdesi primar shëndetësor definohet si “kujdes esencial shëndetësor i cili është universalisht i qasëshëm për individët dhe familjet në komunitet me anë të mënyrave të pranueshme për ta, përmes pjesëmarrjes së tyre të plotë dhe me një çmim që komuniteti në një vend mund ta përballojë. Mjekësia primare formon një pjesë integrale të sistemit shëndetësor të vendit e që në fakt është bërthamë e tij, si dhe, kontribuon në zhvillimin e përgjithshëm social dhe ekonomik të një vendi.”⁵²

Në Pejë, sikurse edhe në 36 komunat tjera, ofrimi i shërbimeve primare shëndetësore është i planifikuar që të realizohet përmes konceptit të mjekësisë familjare, i cili duhet të rrisë dhe zhvillojë idenë e masave parandaluese për t'i adresuar problemet shëndetësore në rrënjë. Momentalisht, përveç Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, janë edhe 22 pika të tjera të Mjekësisë Familjare në Pejë, që duket se mjaftojnë për të mbuluar tërë territorin e komunës si dhe t'i plotësojnë nevojat e popullatës për kujdes mjekësor.

Duke u bazuar në statistikat e shëndetësisë të Agjencisë Kosovare të Statistikave për vitin 2013, në objektet e kujdesit primar mjekësor në Pejë kanë qenë në shërbim 289 persona. Nga ky total, 70 janë mjek familjar, 25 stomatolog, dhe 194 punëtor teknik medicinal. Duke u bazuar në gjetjet tona, me numrin e ndërtesave të shërbimit mjekësor dhe personelit të punësuar, ka kapacitet të mjaftueshëm për t'i plotësuar kërkesat e qytetarëve, rrjedhimisht, të fëmijëve.⁵³ Megjithatë, shumë probleme të tjera, që do të listohen në raport, janë duke e penguar shfrytëzimin e potencialit të plotë njerëzor dhe shërbimeve që janë në dispozicion në këto qendra të kujdesit primar mjekësor.

	MJEK I MJEKËSISË FAMILJARE	DENTIST	PUNËTOR TEKNIK	PSIKOLOG
2013	70	25	194	0
2012	72	25	200	0
2011	201		236	0
2010	201		236	0

Fig. 6 – Statistikat e personelit në shëndetësinë primare në Pejë

Në bazë të këtyre statistikave, proporcioni i mjekëve të mjekësisë familjare me banorë është 1:1,378. Përdërisa, proporcioni i mjekëve të mjekësisë familjare në proporcion me numrin e fëmijëve në komunë është 1:430 ose thënë me fjalë të tjera, kemi një mjek për 430 fëmijë. Përkundër faktit që ky numër tregon se

52 Kujdesi Primar Shëndetësor. Alma-Ata 1978, (1978), Organizata Botërore e Shëndetësisë.

53 Statistikat e Shëndetësisë 2013, Agjencia Kosovare e Statistikave.

mbulueshmëria e nevojave të qytetarëve është në proporcionin e duhur me personelin mjekësor në këto qendra të shëndetësisë, fenomeni i mbingarkesës së qendrave familjare që ndodhen në zonën urbane të qytetit është prezent edhe në Pejë. Edhe pse numri i mjekëve dhe i qendrave familjare është i mjaftueshëm, problem është gjendja e ndërtesave dhe kualiteti i shërbimeve që këto qendra të kujdesit mjekësor ofrojnë.

Përderisa ofrimi i shërbimeve mjekësore është deleguar në nivelin qendror, furnizimi me pajisjet e nevojshme mbetet i centralizuar. Si rrjedhojë, ka vonesa në përgjigje nga niveli qendror për kërkesat e nivelit lokal, andaj, shumë nga objektet e lokalizuara në zonat rurale janë të furnizuara keq, gjë që paraqet një ndër problemet më këmbëngulëse në komunë në këtë sektor. Për më tepër, kushtet e në të cilat ndodhen këto objekte në zonat rurale janë më pak të kënaqshme. Duke pasur këto elemente parasysh, del se qasja në shërbimet e kujdesit mjekësor nuk është e shpërndarë njëtrajtësisht për të gjithë. Përderisa ky është një problem i përgjithshëm për komunën, ky fenomen ndikon direkt tek fëmijët e familjeve që jetojnë në këto zona e posaçërisht komunitetet pakicë.

Sipas Raportit të Progresit, “në mungesë të ndërtesave adekuate mjekësore, përkujdesja mjekësore dhe shërbimet e rehabilitimit për personat me të ardhura shumë të vogla, e veçanërisht personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarve që jetojnë në varfëri, janë jo adekuate”⁵⁴. Për më shumë, pagesat e gatshme vazhdojnë të pamundësojnë qasjen në kujdes mjekësor për të gjithë.

Përderisa numri i mjekëve që momentalisht punojnë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare është i mjaftueshëm për t’i përmbushur nevojat e popullsisë, është mungesa e pajisjeve në qendrat e mjekësisë në disa zona rurale që e bëjnë të pamundur praktikimin e profesionit. Edhe pse Strategjia e Shëndetësisë e Kosovës është e fokusuar drejt ofrimit të shërbimeve të drejta për të gjithë, situata momentale në disa pjesë të komunës e tregon të kundërtën.

Kjo ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e shërbimeve që ofrohen në institucionet e kujdesit primar të mjekësisë, që me njëfarë mënyre e ngarkon sistemin duke pasur një invazion në qendrat e mjekësisë primare që gjenden në qytet nga pacientët që vijnë nga zonat rurale. Në njëfarë mënyre kjo ndikon tek pacientët pasi që e vështirëson qasjen e shpejt në shërbime si dhe njëkohësisht rrit kostot për ata. Në anën tjetër, një fenomen i tillë ndikon gjithashtu në kualitetin e shërbimeve që ofrojnë mjekët.

Petrit Loci, Drejtor i Departamentit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Pejës, thekson që një tjetër problem i madh është mungesa e kartelave të historisë shëndetësore të pacientëve, një problem që direkt po e pamundëson funksionalizimin e plotë të kujdesit familjar. Në mungesë të kartelave të shëndetësisë, listës së pacientëve, dhe sistemit të intranetit, sukcesi i performancës së sektorit të mjekësisë primare vështirësohet.

Kartelat e shëndetësisë janë një mjet shumë i mirë që do të ndihmonin mjekët për t’i shërbyer pacientët më mirë, si dhe do të ndihmonin drejt ndërtimit të një sistemi të unifikuar të historisë shëndetësore të pacientëve, gjë që përfundimisht shpie te mundësia e intervenimeve mjekësore më efektive në çdo stad.

Përderisa implementimi i këtyre masave do të shihej si investim në interes të publikut të gjërë, këto masa sigurisht që do të krijonin kushte të favorshme për mirëqenien e fëmijëve në komunë. Në këtë aspekt, është me rëndësi të përmenden gjetjet e fokus grupit që tregojnë faktin se autoritetet e shkollës nuk kanë një mekanizëm për të përcjellë statusin shëndetësor të nxënësve dhe rrjedhimisht bëhet e pamundur që atyre t’ju ofrohen kushte dhe ndihmë në përputhje me nevojat e tyre dhe problemet e evidentuara në statusin shëndetësor. Është përmendur po ashtu fakti së për shkak të mungesës së një udhëzimi administrativ nga strukturat komunale, fëmijët fillojnë të shkojnë në shkollë pa kaluar nëpër kontrollet e rregullta mjekësore. Jo vetëm që fëmijët nuk kalojnë nëpër këto kontrolle në fillim, por ka mungesë të vizitave të rregullta mjekësore nëpër shkolla edhe gjatë vitit. Ky problem duket se adresohet në nivelin parashkollor, megjithatë mungesa e kontrolleve të rregullta mjekësore gjatë shkollimit të nxënësve është duke ndikuar direkt në performancën e fëmijëve në njërin anë dhe në punën e shkollave në anën tjetër. Kartelat e shëndetësisë po ashtu përmirësojnë sistemin e referimit të pacientëve në nivelin tjetër nga niveli primar në atë sekondar dhe terciar dhe anasjelltas.

54 Raporti i Progresit për Kosovën 2014. (2014), Komisioni Europian.

Në këtë aspekt ka nevojë për mobilizim të menjëhershëm në nivelin lokal. Përderisa kemi parë që investimet në këtë sektor kryesisht janë të fokusuar në ndërtim dhe renovim të ndërtesave, nuk shohim tendenca, projekte ose vija buxhetore që marrin përgjegjësi për të adresuar problemin në fjalë. Alternativa për mundësi të financimit mund të arrihen duke lidhur marrëdhënie me donator ndërkombëtar që do të investonin së paku në instalimin e sistemit të intranetit për të shmangur evazionin e pacientëve nga qendrat e shëndetit primar në pjesën rurale dhe rastet e doktorëve që duhet të kontrollojnë një numër tre herë më të lartë të pacientëve nga limiti i caktuar vjetor.

Në anën tjetër, edhe pse investimet kapitale në këtë sektor janë fokusuar në ndërtimin e ndërtesave dhe mirëmbajtjen dhe renovimin e tyre përkatës, prap se prap këto investime nuk janë në vijë më standardet Europiane dhe si të tilla nuk ofrojnë qasje të lehtë për njerëzit me aftësi të kufizuara. Kjo përfaqëson një problem të madh për të gjithë ata që kane ndonjë lloj paaftësie, qoftë ai person i rritur apo fëmijë, për tu qasur në këto ndërtesa dhe t'i qasen lirshëm qendrave mjekësore.

Pabarazitë në aspektin e lokacionit, statusit social, dhe kombësisë vënë në dukje se pa marrë parasysh performancën buxhetore relativisht pozitive të sistemit shëndetësor, prap se prap, kemi dështim në drejtim të ofrimeve të shërbimeve kualitative dhe kushteve adekuate për shfrytëzimin e shërbimeve mjekësore për një pjesë specifike të popullatës. Investimet duhet të kanalizohen në drejtim të identifikimit të mënyrave më të mira për t'i përmirësuar kushtet për këtë pjesë të marginalizuar të popullatës dhe pastaj të caktohen resurset financiare për të adresuar problemet dhe për të siguruar mbulesë të plotë dhe të barabartë të shërbimeve shëndetësore për të gjithë. Në këtë pikë ne konstatojmë se përbërja e buxhetit lokal momentalisht nuk është e tillë që të reflektoj nevojat e qytetarëve. Për më shumë, pjesëmarrësit në fokus grup konstatuan se mënyra se si hartohet buxheti po ashtu ndikohet nga agjenda politike e partive të ndryshme që vijnë në pushtet. Me fjalë tjera, nëqoftëse kandidatët për kryetar kanë bërë premtime elektorale që do të ndërtojnë rrugë në pjesë të caktuara të komunës, atëherë mjetet financiare do të alokohen në atë drejtim në dëm të investimeve në përmirësimin e shërbimeve mjekësore.

Përveç gjitha problemeve të cekura, ka po ashtu një mungesë të vetëdijes në rrethet familjare dhe në mesin e komuniteteve rreth menaxhimit adekuat të kujdesit shëndetësor në nivel shtëpiak, zhvillimit fizik dhe kognitiv të fëmijut dhe shëndetin e përgjithshëm riprodhues. Alokimet momentale të resurseve buxhetore janë të fokusuar në programe si kujdesi kurativ dhe programe për administrimin e barnave, ndërsa shpenzohet shumë pak për investime në programe të mjekësisë preventive dhe përmirësimin e shërbimeve primare mjekësore.⁵⁵

Me rritjen e popullsisë së të rinjve të pjekur dhe të numrit të familjeve në komunë, lind nevoja për prezantimin e masave parandaluese përmes promovimit, edukimit dhe trajtimeve mjekësore, të cilat adresojnë probleme si pirja e duhanit, HIV/AIDS, sëmundjet e transmetuara seksualisht si dhe programet për imunizim për foshnje dhe fëmijë. Këto masa do të ndihmonin që të kemi një popullatë më të shëndosh si në nivel lokal ashtu edhe në nivel të vendit.

KOORDINIMI I BUXHETIT PËR SHËNDETËSI ME NEVOJAT E FËMIJËVE NË KOMUNËN E PEJËS

Përderisa ne kemi identifikuar një numër trendësh që mbizotërojnë në fushën e menaxhimit të shpenzimeve publike në sektorin e shërbimit primar mjekësor në këtë komunë, fokusi tani do të zhvendoset tek implikimet e këtyre trendëve në mirëqenien e fëmijëve në zonën ku ata jetojnë.

Me përjashtim të trendit të vitit të kaluar, rritja e alokimit të buxhetit në shëndetësi është një hap pozitiv drejt sigurimit të cilësisë më të lartë të mjekësisë preventive me një rritje të shanseve për të mundësuar qasje më të mirë në shërbimet mjekësore edhe për grupet e marginalizuara të popullsisë. Megjithatë, në mënyrë që të përdoren resurset më efektivisht, ka nevojë për një vlerësim komunal të nevojave të njerëzve

55 Fëmijët, Vitet e hershme, UNICEF Kosova.

me fokus në nevojat e fëmijëve. Përderisa praktika e deritanishme ka qenë e tillë që veprimet komunale në këtë sektor janë koordinuar me politikat e orkestruara nga niveli qendror, Petrit Loci, Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, deklaroi se momentalisht Drejtoria është duke bashkëpunuar me UNDP për të realizuar një vlerësimi të nevojave të qytetarëve si dhe të nevojave të ofruesve të shërbimeve mjekësore. Duke pasur këtë analizë komunale edhe alokimi i fondeve brenda departamentit mund të bëhet në mënyrë më efikase. Për më shumë, kjo është një shans e mirë për t'i vlerësuar nevojat e fëmijëve, për të përpiluar statistika për kushtet e tyre shëndetësore sipas strukturës dhe të bëhet priorizimi i investimeve dhe shpenzimeve brenda sektorit të shëndetësisë në komunë. Deri më tani, përderisa në të vërtetë fëmijët përfitojnë nga sistemi primarë i shëndetësisë, nuk ka pasur ndonjë veprim specifik në aspektin e alokimeve buxhetore për të ju përgjigj nevojave të tyre, e aq më pak ka pas programe specifike të cilat do të adresonin problemet më serioze shëndetësore me të cilat ballafaqohen ata.

Në anën tjetër, rritja në alokimet e resurseve financiare për këtë sektor duhet të shoqërohet paralelisht me zhvillimin e kapaciteteve për të planifikuar dhe monitoruar përdorimin e këtyre resurseve, gjë që momentalisht nuk ndodh. Rezultati është se ka mungesë të kontrollimit të përdorimit të resurseve dhe planifikimi nuk bëhet në bazë të nevojave. Në mënyrë që të përmirësohet kapaciteti i absorbimit të alokimeve më të mëdha buxhetore për mjekësi preventive dhe programet vertikale të shëndetësisë, një njësit i planifikimit, monitorimit dhe vlerësimit do duhej të zhvillohet në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë për të mundësuar zhvillimin e strategjive efektive për përdorimin e resurseve si dhe për të monitoruar përdorimin e atyre resurseve. Planifikimi efektiv në këtë sektor kërkon ndërtimin e kapaciteteve brenda ministrisë e gjithashtu të atyre që janë të përfshirë në planifikimin shëndetësor në nivelin lokal, duke përfshirë këtu OJQ-të që kanë filluar të punojnë përkrah ofruesve të shërbimeve publike mjekësore për të përmirësuar ofrimin dhe menaxhimin e shërbimeve të mjekësisë preventive.

Gjithashtu, statistikat krahasimore, në pajtim me Raportin e KE, tregojnë se shpenzimet në shëndetin publik janë ndër më të ulëtat në rajon. Me një ekzekutim të buxhetit gati 100% në secilën kategori, ka pak hapësirë në Komunën e Pejës për të prezantuar reforma dhe politika të reja të cilat do të shpinin drejt përmirësimit të qasjes dhe të cilësisë në shërbimet e kujdesit primar mjekësor për qytetarët e saj dhe për fëmijët në veçanti. Rrjedhimisht lind nevoja për të tërhequr financime ndërkombëtare shtesë nga donatorët si dhe të punohet drejt ngritjes së kapaciteteve lokale dhe kapaciteteve administrative për të implementuar projekte që implementohen nga ky lloj i mbështetjes financiare. Përfundimisht, raporti i KE më tutje thekson faktin që vdekshmëria e fëmijëve mbetet ndër më të lartat në Evropë.⁵⁶

Përderisa ky është një shqetësim kombëtar, nuk duhet të lejohet që të lehet larg vëmendjes dhe përkushtimit të politik bërësve lokal.

VËSHTRIM I SISTEMIT TË ARSIMIT NË NIVELIN QENDROR DHE LOKAL

Qeveria e Kosovës (2011-2016) e ka identifikuar arsimin si ndër prioritetet dhe objektivat kryesore dhe si e tillë i ka fokusuar përpjekjet e saja për të arritur një inkuadrim më gjithëpërfshirës në arsimim dhe zhvillimin e një modeli për të vlerësuar arritjet e nxënësve, si dhe ofrimin e mundësive për qasje të barabartë në edukim kualitativ.⁵⁷

Përderisa gjatë mandatit të kaluar, investimet në arsim janë rritur mbi 100 milion EUR, shumica e fondeve janë destinuar drejt rritjes së pagave për mësuesit të cilat janë rritur për 38%.⁵⁸

Megjithatë, në raportin e fundit të progresit për vitin 2014, është vënë re se ka pasur përparime të kufizuara për përmirësimin e kualitetit në sektorin e edukimit. Është konkretisht e specifikuar se shpen-

56 Raporti i Progresit për Kosovën 2014, (2014), Komisioni Europian.

57 Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2016, (2011). Zyrja e Kryeministrit, Qeveria e Kosovës.

58 *Ibid.*

zimet publike për edukim janë më të ulëta se mesatarja prej 4.3% e vendeve me të ardhura të ulëta dhe të mesme. Duke u bazuar në përfundimet e raportit, përparimet në këtë fushë kanë qenë të ngadalshme. Arsimi në Kosovë është i organizuar në këtë mënyrë:

- Arsimi parashkollor, kopshti, (3-6 vjeç)
- Shkollimi fillor, 5 vjet (6-11 vjeç)
- Arsimi i mesëm i ulët, 4 vjet (12-15 vjeç)
- Arsimi i mesëm i lartë, Gjimnazi ose Trajnimi Profesional 3 deri në 4 vjet (16-19 vjeç)
- Studimet universitare dhe Master (19-26 vjeç)
- Studimet e doktoratës

Momentalisht, njëra nga sfidat më të mëdha në nivelin vendor por edhe atë komunal, që është edhe njëra nga gjetjet e Objektive të Zhvillimit të Mijëvjeçarit për vitin 2007 në Kosovë, është regjistrimi i ulët i fëmijëve në arsimin parashkollor.⁵⁹

Në këtë aspekt, Kosova qëndron shumë mbrapa krahasuar me vendet e rajonit. Përgjithësisht, ka një mungesë të vetëdijes për të stimuluar zhvillimin fizik dhe kognitiv të fëmijëve në moshë të hershme.

Vlerësohet se në nivel vendi, vetëm 3% e fëmijëve vijnë në edukimin parashkollor.⁶⁰

Shifrat për komunën e Pejës janë më të mira se mesatarja kombëtare, megjithatë, edhe në këtë komunë regjistrimi i fëmijëve në arsimin parashkollor është i ulët, duke arritur shifrën e 14%. Më konkretisht, nga 10,813 fëmijë të moshës 0-6 vjeç në vitin 2011, vetëm 1,542 fëmijë janë regjistruar në arsimin parashkollor për vitin akademik 2011-2012. Sa i përket arsimin fillor dhe atij të ulët sekondar, shkollët e regjistrimit janë dukshëm më të kënaqshme, megjithatë 5% e fëmijëve nuk janë të regjistruar në shkolla. Kur analizohen statistikat për shkollimin e lartë dytësor, ne vërejmë se nga 9,395 fëmijë të moshave 15-19 vjeçare, vetëm 6,581 prej tyre apo 70% janë të regjistruar në shkolla të mesme.⁶¹

Duke pasur parasysh që në Kosovë arsimi është obligativ deri në moshën 15 vjeçare,⁶² ka nevojë që të përpilohen masa të orientuara specifiku kështu kah luftimi i fenomenit të regjistrimit të ulët të fëmijëve në arsimin obligativ.

Një tjetër problem madhor është nevoja për të përmirësuar qasjen në arsim cilësor të grupeve të marginalizuara, duke përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian.⁶³

Vendi mbetet mbrapa në ofrimin e qasjes në arsim cilësor për të gjithë e që manifestohet ose gjeografikisht (më pak nxënës në zonat rurale), perspektivën gjinore (më pak nxënëse femra), nevoja speciale (më pak fëmijë me nevoja të veçanta vijnë në mësim) etj. Qeveria ka marrë masa për të parandaluar lënien e shkollës, duke përfshirë punëtorin me prindër, student dhe me komunitete në tërësi, për duhet të vazhdohet me përpjekje edhe më tutje. Në ndërkohë, nxënësit nga komunitetet pakicë kanë marrë mbështetje financiare. Megjithatë, fëmijët e komuniteteve Rom, Ashkali, dhe Egjiptian, si dhe fëmijët me nevoja të veçanta vazhdojnë të përballen me qasje të limituar në arsim. Një nga faktorët që ka rritur numrin e inkuadrimin në shkolla ka qenë shpërndarja e librave shkollor falas, një projekt që Qeverisë së Kosovës i kushtoi 19 milion EUR.⁶⁴

Ky projekt i ka dhënë frytet e tij në rritjen e kualitetit të pjesëmarrjes së nxënësve në të gjithë nivelin arsimor të Kosovës.

Në Pejë, fëmijëve u mundësohet arsimi i detyrueshëm pa pagesë. Siç është e rregulluar me Ligjin mbi Arsimin, vijimi i mësimin është i obligueshëm për të gjithë fëmijët e moshës 6 deri 15 vjeçare.⁶⁵

59 Objektivat e Zhvillimit të Mileniumit, Raporti i dytë për Kosovën, (2007), Riinvest.

60 *Ibid.*

61 Statistikat e edukimit 2013. Agjencia Kosovare e Statistikave.

62 Edukimi primar dhe sekondar, Portali Shtetëror i Republikës së Kosovës.

63 Raporti i Progresit, (2014), Komisioni Europian.

64 Programi Qeverisës i Qeverisës së Kosovës 2011-2014. (2011.), Zyrja e Kryeministrit, Qeveria e Kosovës.

65 Edukimi primar dhe sekondar, Portali Shtetëror i Republikës së Kosovës.

BAZA LIGJORE PËR SEKTORIN E ARSIMIT

Paketa ligjore që rregullon të drejtën e fëmijëve për arsimim në Kosovë është e fokusuar drejt rregullimit dhe menaxhimit të arsimit duke filluar nga arsimi para universitar, ose niveli 0 sipas ISCED deri te niveli 4 i ISCED i cili është niveli më i lartë i arsimit profesional jo sekondar. Përveç paketës ligjore, janë edhe një numër i strategjive rregullative kombëtare dhe shtetërore për këtë fushë. Korniza ligjore që e garanton të drejtën e fëmijëve për arsimim është e pasur dhe përbëhet nga ligjet në vijim: Ligji për Arsimin Parashkollor, Ligji mbi Arsimin Para universitar, Ligji mbi Arsimin dhe Trajnimin Profesional, Ligji mbi Arsimin në Komunat e Kosovës, Ligji mbi Provimin Përfundimtar ose Testi Shtetëror i Maturës, të cilët në dispozitat e tyre mbulojnë edhe përgjegjësitë e strukturave lokale. Këto ligje plotësohen më tej me Ligjin mbi Inspektimin e Arsimit në Kosovë, Ligji mbi Publikimin e Librave Shkollor, Burimet Arsimore të Mësimit, Materialet për Lexim dhe Dokumentet Pedagogjike, dhe Ligjin mbi Kualifikimet Kombëtare. Këto ligje së bashku e garantojnë të drejtën e fëmijëve për arsimim.

Kjo kornizë ligjore synon të garantoj barazi dhe cilësi në shërbime duke krijuar kushte të favorshme për qasje dhe mbulueshmëri universale. Në nivelin qendror, siç është thënë në Strategjinë Kombëtare për Edukim 2011-2016, synimi është që:

- Të mbështesë, udhëzoj, rregulloj, koordinoj dhe promovoj arsimin kualitativ për të gjithë qytetarët,
- T'i udhëheqë të gjithë nën sektorët në planifikimet e tyre afatmesme dhe vjetore dhe praktikën e përpilimit buxhetor,
- Të ofroj një bazë për koordinim, negociim me agjencitë Qeveritare, partnerët zhvillimor dhe palët tjera të interesit në sektorin e arsimit, si dhe, për të definuar fushën dhe përdorimin e planifikimit afatgjatë dhe investimet në sektorin e arsimit të mbledhura nën një membranë të vetme të financimit dhe resurseve.⁶⁶

Duke u bazuar në dispozitat dhe rregullat ligjore, fëmijët kanë të drejtë për pjesëmarrje aktive në organizimin e jetëve të tyre përdorisë mësuesit janë të obliguar të respektojnë mendimin e secilit fëmijë dhe të sigurohen që ata ndihen të integruar në shoqëri.

Siç parashihet në Ligjin mbi Arsimin, përgjegjësitë e komunave janë vetëm në fushën e arsimit para universitar. Si e tillë, duke u bazuar në "Strategjinë për zhvillimin e arsimit para universitar në Kosovë"⁶⁷ ideja është që të ndërtohet një sistem gjithëpërfshirës i arsimit që ofron kushte për arsim cilësor për të gjithë individët duke promovuar veti të përhershme dhe vlera të demokracisë qytetare. Gjithashtu ka pasur një zotim për përkushtim për rritjen e indeksit të përfshirjes së fëmijëve nga 0-5 vjet për 7%, përfshirjen prej 90% të fëmijëve të moshave 5-6 vjeçare në arsim fillor, si dhe trajnime të mësuesve në programe cilësore dhe të akredituara.⁶⁸

Duke u bazuar në Ligjin e Arsimit Para universitar, Neni 3 thekson se asnjë personi nuk duhet t'i mohohet e drejta për arsim.⁶⁹

Duhet të jetë detyrë e përgjithshme e ministrisë përgjegjëse, komunave dhe institucioneve arsimore/ trajnuese dhe të gjitha strukturave tjera të përfshira në arsimin para universitar, siç është e rregulluar me këtë ligj dhe të gjitha ligjet tjerë të aplikueshëm, për të ofruar një shërbim efektiv, fleksibël, përfshirës dhe profesional të dizajnuar që t'ju jap të gjithë nxënësve mundësi të barabarta në qasjen në arsim në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike dhe të promovoj edukimin dhe zhvillimin e tyre social.

Komunat janë përgjegjëse për kompetencat shtesë në vijim: ndërtimi i objekteve të arsimit dhe trajnimit, mirëmbajtja dhe riparimi i premisave dhe pajisja e institucioneve të edukimit dhe trajnimit; sigurimi i një ambienti të shëndetshëm për nxënësit dhe stafin, duke përfshirë ujën, kushtet sanitare higjienike,

66 Strategjia e arsimit në Kosovë 2011-2016, (2011), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Qeveria e Kosovës.

67 Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar në Kosovë 2007-2017, (2007), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Qeveria e Kosovës.

68 *Ibid.*

69 Ligji No. 04/L-032 mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

shërbimin shëndetësor, si dhe një ambient të sigurt, përfshirë shërbimet komunale të qëndrueshme si dhe sigurim efektiv. Përderisa, përmes bashkëpunimit me prindërit, policinë dhe autoritetet tjera është e obliguar të marrë hapa për të adresuar në mënyrë efektive sjelljet e dhunshme dhe ngacmuese si dhe abuzimin substancial në ose përreth institucionit përkatës.

SHPENZIMET PËR ARSIM NË NIVELIN QENDROR

Në mënyrë që të kemi një pamje të përgjithshme për trendët në sektor, para se të vazhdojmë më specifikat e Komunës së Pejës, ia vlen të analizohen dhe kuptohen trendët e shpenzimeve dhe buxhetimit në nivel qendror në sektorin e edukimit. Siç mund të shihet nga grafi më poshtë, në 5 vitet e fundit investimet mesatare në sektorin e arsimit në nivelin qendror kanë qenë diku rreth 3% të totalit të buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Përderisa shpenzimet publike në edukim si përqindje e BPV arrijnë një mesatare deri në 4% sipas raporteve të Bankës Botërore, që është përafërsisht në vijë më trendët në vendet e rajonit.⁷⁰

Është specifikisht e cekur se shpenzimet publike në arsim kanë pasur zbritje për 0.1% në 3.8% të BPV në vitin 2013. Si e tillë vazhdon të mbetet prap më pak se mesatarja e vendeve me të ardhura të ulëta të cilat investojnë mesatarisht 4.3% të BPV-së. Shpenzimet për edukim si përqindje e BPV sillen rreth 4-5% në vendet e Bashkimit Evropian.




Fig.7 – Trendët e alokimeve buxhetore të MASHT në krahasim me KB për periudhën 2010-2014

Përderisa buxheti i alokuar për Ministrinë e Shkencës, Arsimit dhe Teknologjisë është rritur në terma nominale, trendët pozitive janë shfaqur me një shkallë zbritëse. Megjithatë, siç mund të shohim nga shifrat më lart buxheti për edukim si përqindje e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës është rritur konstant nga viti 2011, kur përjetoj një rënie drastike prej 7% nga një shumë e alokuar prej 37 milion EUR në vitin 2010 në 34 milion EUR në vitin 2011. Në anën tjetër, ne mund ta identifikojmë lehtë që rritja e përqindjes së shpenzimeve në arsim ka arritur numra dyshifror, që normalisht do të konsiderohej si politikë shumë pozitive e Qeverisë duke pasur parasysh theksin që i vihet nevojës për investim në arsim cilësor në mënyrë që të korrim kthim domethënës në investim në të ardhmen.

Megjithatë, ky nuk është realiteti në këtë rast. Siç dëshmohej në tabelën më poshtë, alokimi i buxhetit është kryesisht i fokusuar në mbulimin e pagave të punëtorëve në sektor si dhe për të financuar investimet kapitale. Megjithatë, mund të vërehet një raport shumë interesant në mes të dy kategorive, ku mund të shohim se përderisa buxheti për paga është rritur vazhdimisht në 5 vitet e fundit, vija buxhetore për investime kapitale ka lëvizur me një shkallë të qëndrueshme ose me një rritje shumë të moderuar.

70 Shpenzimet në arsim (% e BPV), (2007), Banka Botërore.

Shqetësimi më i madh në këto shifra është e lidhur me përqindjen e buxhetit të rezervuar për paga, që është rezultat direkt i vendimit të Qeverisë paraprahe për të rritur pagat për zyrtarët publik. Shifrat e cekura në Fig.8 tregojnë se momentalisht, deri në 20% të buxhetit për arsim shpenzohet në këtë kategori.




Fig. 8 – Alokimi buxhetor në arsim bazë të kategorive në Pejë në vitin 2014

Përderisa besohet se rroga më të mëdha për mësues duhet të ndikojnë për të mirë në motivimin e tyre dhe rrjedhimisht kjo të përkthehet në shërbime arsimore të cilësisë më të lartë për nxënësit dhe studentët, prezantimi i kësaj rritje të menjëhershme pa ndonjë kushtëzim, jo domosdoshmërisht do të rezultojnë drejt një përmirësimi të cilësisë në sektorin e arsimit në vend.

Përderisa ofrimi i arsimit para universitar tashmë është kompetencë e deleguar plotësisht nga niveli qendror te ai lokal, siç do të elaborohet thellësisht më tej në studim, konstatohet se buxheti për zhvillimin e këtij niveli të arsimit arrin 9,51% të buxhetit total të MASHT-it. Kjo shifër është zvogëluar për 2.5% nga 12.1% në vitin 2013. Në aspektin e përgjithshëm, Qeveria duket se nuk e ka në prioritet zhvillimin e mëtutjeshëm të këtij sektori përkundër faktit që ky shihet si investimi më i mençur për çdo vend. Kjo është veçanërisht e vërtetë për Kosovën, një shtet i ri që ka nevojë për një bazë të shëndoshë akademike dhe arsimore për një qëndrueshmëri afatgjate të mirëqenies sociale në vend.

Buxheti i alokuar për arsimin para universitar nuk ka pasur rritje serioze në 5 vitet e kaluara. Në fakt ka ngecur në një buxhet të alokuar mesatarisht prej 4.8 milion EUR në bazë vjetore, ku këtë vit buxheti është zvogëluar në krahasim me vitin paraparak.

Në anën tjetër, buxheti për arsim është i vetmi që është i ndarë në nën kode të etiketuara qartë duke na lejuar që t'i përcjellim lehtë trendet në alokimet e fondeve specifike për programe specifike. Në këtë aspekt, në kuadër të kodit buxhetor për arsim para universitar gjendet nën kodin e cili qartë e ndanë buxhetin për ofrimin e shërbimeve arsimore për personat me aftësi të kufizuara dhe fëmijët me nevojë të veçanta, nën kodin për trajnimin dhe arsimimin e mësuesve, si dhe nën kodin për zhvillimin e programit bazik për arsim, kod ky që u prezantua në vitin 2013.

	2010	2011	2012	2013	2014
MASHT	37,709,899.00	34,817,820.00	40,984,755.00	45,705,848.00	50,297,252.00
NDRYSHIMI NGA VITI NË VIT(EUR)	N/A	(2,892,079.00)	6,166,935.00	4,721,093.00	4,591,404.00
NDRYSHIMI NGA VITI NË VIT(%)	N/A	-8.31%	17.71%	11.52%	10.05%
ARSIMI PARA UNIVERSITAR	4,292,479.00	4,786,775.00	5,398,699.00	5,576,099.00	4,785,942.00
ARSIMI/NEVOJA TË VEÇANTA	1,318,134.00	1,645,831.00	1,645,831.00	1,645,831.00	1,645,831.00
TRAJNIMET E MËSUESVE	1,936,039.00	1,035,745.00	935,745.00	935,745.00	861,195.00
PROGRAMI I ARSIMIT BAZIK				1,000,000.00	1,000,000.00

Fig. 9 – Buxhetimi për shpenzime në sektorin e arsimit në nivel qendror në Kosovë

Duke u bazuar në trendët buxhetore, vërehet se buxheti i alokuar për këto kategori është simbolik dhe nuk duket se u adaptohet rregullisht ndryshimeve, sepse ka rast kur buxheti i njëjtë alokohet për tri vite radhazi, siç është rasti me vijën buxhetore që mbulon shpenzimet që dalin nga ofrimi i shërbimeve arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara. Kjo përçon mesazhin se alokimi i këtyre vijave buxhetore nuk merret seriozisht nga ana e Ministrisë për shkak të mungesës së adaptimit të buxhetit nga viti në vit. Përfundimisht kjo e vë në pikëpyetje efikasitetin e këtyre vijave buxhetore në aspektin e ofrimit të arsimit kualitativ dhe të barabartë për të gjithë.

ANALIZË E BUXHETIT PËR ARSIM NË KOMUNËN E PEJËS

Pjesa në vazhdim fokusohet në analizën e alokimeve buxhetore për sektorin e arsimit në Komunën e Pejës me qëllim për të kuptuar përkushtimin e liderëve lokal për rritjen e kualitetit dhe qasjes në arsim për fëmijët e kësaj komune.

ARSIMI	ADMINISTRIMI	% TOTAL	PARASHKOLLOR	% TOTAL	FILLOR	% TOTAL	I MESËM	% TOTAL	TOTAL
2010	76,694.00	1.23%	309,458.39	4.97%	4,139,118.65	66.52%	1,697,379.76	27.28%	6,222,650.80
2011	345,703.39	4.23%	315,694.72	3.86%	4,984,824.27	60.98%	2,528,112.37	30.93%	8,174,334.75
2012	605,986.46	7.42%	333,319.12	4.08%	4,874,320.47	59.68%	2,353,150.04	28.81%	8,166,776.09
2013	1,010,065.97	11.84%	327,764.45	3.84%	4,908,598.85	57.53%	2,285,882.00	26.79%	8,532,311.27
2014	1,050,182.90	12.34%	341,604.31	4.01%	4,683,878.69	55.03%	2,436,577.33	28.62%	8,512,243.23

■ Fig. 10 – Buxheti për arsim në Komunën e Pejës i ndarë në kategoritë buxhetore

Duke u bazuar në tabelën më lart, kuptojmë se qysh nga viti 2011 kur ka pasur një rritje prej 2 milion EUR ne buxhetin total nga 6 milion EUR në vitin 2010, duke arritur në dallimin prej 12%, buxheti i alokuar në vitet në vazhdim ka mbetur pak a shumë në të njëjtën shkallë. Kjo është gjithashtu në vijë me prezantimin e fondit specifik për edukim nga Ligji për Menaxhimin e Financave të Pushtetit Lokal si dhe decentralizimi i sistemit arsimor, që u bë në të njëjtin vit. Siç tanimë ne e dimë, buxheti kalkullohet duke u bazuar në një formulë të qartë të caktuar nga Komisioni i Granteve i cili konsideron parametra të ndryshëm për secilën komunë. Përderisa në njërin anë, ky lloj menaxhimi i financave publike mund të duket pozitiv, sepse garanton financimin minimal për t'i kryer përgjegjësitë e komunave në fushën e arsimit, në anën tjetër kjo i limiton komunat në aspektin e mundësive për të bërë aranzhime të ndryshme të vijave buxhetore. Përveç këtij kufizimi që është cekur me ligj, fleksibiliteti i qeverive lokale gjithashtu kufizohet nga vendimi i qeverisë për rritjen e pagave për shërbyesit civil. Ky vendim është përkthyer në rroga më të mëdha për mësuesit në kurriz të fondeve të alokuara për investime kapitale ose në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Në vijë me analizën paraprake, statistikën më poshtë edhe një herë përforcojnë faktin se buxheti përdoret në masë të madhe për të mbuluar pagat për mësuesit dhe personelin që punon në këtë sektor. Është interesant të përmendet fakti se 83% e buxhetit të dedikuar për sektorin e arsimit është rezervuar për paga dhe mëditje. Trendi i njëjtë ka qenë i pranishëm që nga viti 2010, ku buxheti i dedikuar për këtë kategori ka arritur 85% të totalit. Kjo më tej tregon se, përkundër faktit që buxheti total për këtë kategori të arsimit mund të jetë rritur nga viti në vit, pjesa më e madhe e buxhetit është e rezervuar për këtë kategori, rrjedhimisht duke i larguar kështu fondet nga investimet kapitale të cilat do të kishin ndihmuar komunën që të përmbushin detyrat që i janë deleguar për ofrimin e shërbimeve më të mira për nxënësit në territorin e saj. Koncentrimi i dytë më i madh i fondeve shkon për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Fondet në këtë kategori përdoren për shpenzimet që rrjedhin nga mbledhjet zyrtare, shpenzime të udhëtimeve dhe akomodimit, pajisje të zyrave, shpenzime të komunikimit etj. Në vitin 2013, përkundër faktit që 12,900 EUR të këtij buxheti ishin alokuar për trajnime dhe arsimim, raporti final i shpenzimeve tregon se këto para nuk janë përdorur fare. Gjithashtu, 30% e këtyre fondeve janë shfrytëzuar për naftë dhe materiale djegëse, ku më pak se 5% janë përdorur për renovimin e ndërtesave të shkollave në komunë.




Fig. 11 – Alokimet buxhetore për kategori në sektorin e arsimit për vitin 2014 – Komuna e Pejës.




Fig. 12 – Diferenca në kategorinë e Rrogave dhe Mëditjeve në arsim në Pejë 2010-2014

Nga 6.5 milion EUR që janë alokuar për shpenzime kapitale në komunë, vetëm 5.5% të tyre janë kanalizuar në sektorin e arsimit. Por fondet e alokuara nuk janë përdorur në tërësi, ku nga raporti i shpenzimeve kuptojmë që vetëm 80.77% të këtyre fondeve janë shfrytëzuar. Rreth 98% e fondeve për investime kapitale në sektorin e arsimit në Pejë në vitin 2013 i janë dedikuar renovimit dhe ndërtimit të ndërtesave për arsim. Përderisa, duke u bazuar në raportin e shpenzimeve për vitin 2013, ne mund të identifikojmë disa investime në kompjuterë dhe pajisje të teknologjisë informative. Duke pasur parasysh që nuk ka shpjegim të saktë se për çfarë destinimi ose përse janë blerë ato pajisje, ne nuk mund të theksojmë nëse ato pajisje janë blerë për arsye të shfrytëzimit nga nxënësit në shkolla apo vetëm për përdorim në zyrat e personelit administrativ. Mungesa e indikacioneve të qarta të shumicës së shpenzimeve brenda vijave të ndryshme buxhetore e pamundëson përcjelljen dhe monitorimin e shpenzimeve dhe identifikimin e qëllimit të përdorimit të tyre. Pamja gjenerale tregon se financimet e në kategori të ndryshme buxhetore janë me njëfarë mënyre të realizuara pa ndonjë analizë të thellë të trendëve në këtë sektor. Arsyet pse theksohet kjo janë:

- Që nga viti 2010, më shumë se 80% e fondeve janë alokuar në kategorinë e pagave dhe mëditjeve,
- Mesatarisht, vetëm 4% e buxhetit të alokuar në sektorin e arsimit përdoret për investime kapitale,
- Nuk ka indikacione të qarta brenda vijave të ndryshme buxhetore për shpenzimet e planifikuara. Me fjalë të tjera, është vështirë të përcillet nëse fondet në kategori të ndryshme dedikohen që t'u përgjigjen nevojave të fëmijëve.

PROBLEMET NË FUSHËN E ARSIMIT NË PEJË

Problemi më i madh i identifikuar gjatë punës në terren, që u potencua fort edhe nga pjesëmarrësit e fokus grupit, është ndërprerja e vijimit të shkollimit nga ana e nxënësve. Duke u bazuar në shifrat e marra nga Agjencia Kosovare e Statistikave, gjatë periudhës 2010-2014, ndërprerja e vijimit të mësimimit nga ana e nxënësve në shkollimin fillorë e ka arritur kulmin e tij në vitin 2011, ku 204 nxënës e kanë ndërprerë vijimin e shkollimit.

KATEGORIA	2009	2010	2011	2012
NXËNËS TË REGJISTRUAR	16,461	15,606	15,569	15,038
NDËRPRERJA E VIJIMIT TË SHKOLLIMIT	63	76	204	113

■ Fig. 13 – Statistikat e numrit të nxënësve që largohen nga shkolla në Komunën e Pejës

Shkaku kryesorë për manifestimin e këtij fenomeni kryesisht është faktori ekonomik. Megjithatë, ndërprerja e shkollimit për shkaqe të ndryshme si: mungesa e sigurisë, transportit, etj., është po ashtu e pranishme. Faktor të tjerë që ndikojnë në mungesën e cilësisë në arsim janë: ndërtesat e shkollave që nuk plotësojnë nevojat bazike për punë, mungesa e laboratorëve dhe materialit arsimor; furnizimi i pamjaftueshëm me tekste shkollore, motivim joadekuat i mësuesve dhe prindërve, etj.

Sipas Arbnor Lajqi nga Iniciativa 6, problemi në këtë pikë është se sistemi arsimor është i dizajnuar në atë mënyrë që të plotësoj nevojat e nxënësve mesatar që nuk kanë nevoja të veçanta. Duke u bazuar në diskutimet në fokus grupet, nxënësit që e braktisin shkollën janë kryesisht fëmijët me vështirësi ekonomike, që jetojnë në zona rurale, që konsiderohet që sillen në mënyrë jo sociale, që kanë probleme shëndetësore ose thjesht nuk mund t'i përshtaten modelit tradicional të arsimit. Përderisa problemi është ekzistent, nuk vërehet një përkushtim serioz të qeverisjes lokale për të alokuar fonde shtesë për t'ju qasur këtyre çështjeve mjaft shqetësuese. Ndërprerja e vijimit të mësimi është gjithashtu indikacion se komunat nuk janë duke pasur sukses në arritjen e obligimeve të tyre, siç është rasti me ofrimin e shërbimeve arsimore në mënyrë kualitative dhe të barabartë.

Megjithatë, aspekti pozitiv i menaxhimit të sektorit të arsimit është që buxheti i alokuar për sektorin e arsimit është fiks pasi që rrjedh nga garantit specifik i shpërndarë në bazë të formulës të përcaktuar në nivelin qendror, siç është qartë e cekur në Ligjin për Financimin e Pushtetit Lokal.⁷¹ Në këtë ligj, tregohet qartë se kur bëhet alokimi i fondeve për komuna, alokimi bëhet përmes formulës së vendosur nga Komisioni i Granteve. Formula merr në konsideratë numrin e nxënësve dhe standardet e ofruara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, numrin e mësuesve, kurikulën kombëtare, arsimin me nevoja të veçanta, shpenzimet që nuk kërkojnë kompensim me pagë, madhësinë e klasave, normat dhe lokacionin.⁷² Duke e krahasuar buxhetin e arsimit me buxhetin për shërbimet e mirëqenies sociale, granti specifik garanton që standardet minimale të nivelit të arsimit parashkollor, fillor, dhe të mesëm të jenë të mbështetura financiarisht, përderisa e njëjta nuk vlen për sektorin e mirëqenies sociale.

RREGULLIMI I PLANIFIKIMIT BUXHETOR PËR T'JU PËRGJIGJUR MË MIRË NEVOJAVE TË FËMIJËVE NË FUSHËN E ARSIMIT NË PEJË

Duke u bazuar në intervistën me Besim Avdimetaj, Udhëheqës i Departamentit të Arsimit në Komunën e Pejës, problemi më i madh deri më tani është ofrimi i kushteve të mira për mësim për fëmijët në shkolla. Me fjalë të tjera, kushtet për të mësuar në ndërtesat ekzistuese janë të pakënaqshme. Ndërsa duke u bazuar në shikimin e shpenzimeve buxhetore lehtësisht mund të identifikohet se investimi në ndërtimin dhe renovimin ose mirëmbajtjen e ndërtesave të shkollës ka qenë fokus primar i investimeve në sektorin e arsimit në nivel lokal. Përderisa investimet në ndërtesa të shkollave ndikojnë direkt në jetët e nxënësve, duke u bazuar në hulumtimet në terren, ne kemi identifikuar se shkollat, edhe ato që gjenden në qendër, janë duke pasur probleme serioze me nivelin e sigurisë në institucionet e tyre.

Pjesëmarrësit në fokus grup shprehin shqetësimin e tyre në lidhje me infrastrukturën përreth shkollave. Ata shprehën nevojën për intervenim të menjëhershëm në përmirësimin e kushteve të sigurisë për fëmijët

71 Ligji No.03/L-049 mbi Financimin e Pushtetit Lokal, Kuvendi i Kosovës.

72 *Ibid.*

në shkollë, që do të thotë të bëhet më i sigurt kalimi i rrugës ose të jenë të mbrojtur gjersa janë në shkollë. Në pajtim me këto deklarata janë edhe të gjeturat e hulumtimit të realizuar nga Syri i Vizionit në shkollën fillore 'Ramiz Sadiku' në Pejë. Në anketimin e bërë, një shumicë e nxënësve janë shprehur që ndihen të sigurt në shkollë, përderisa 22% e të anketuarve u shprehën që ata nuk ndihen të sigurt për shkak të mungesës së trotuareve pranë shkollës, gjë që rrit ekspozimin ndaj rrezikut për tu ndesh nga makinat që qarkullojnë pranë shkollës. Arsytet tjera që i bëjnë ata të ndihen të pasigurt janë: prezenca e qenjve rrugaç si dhe kërcënime të vazhdueshme nga grupet e të ashtuquajturve 'huligan të rrugës.'⁷³

Në këtë aspekt, përderisa 1.2 milion EUR nga buxheti për shpenzime kapitale janë alokuar për investime në rrugë, kanalizime dhe furnizim me ujë, fëmijët në disa shkolla vazhdojnë të jenë të ekspozuar ndaj rreziqeve serioze kur shkojnë në shkollë. Njëra prej këtyre shkollave është Shkolla Fillore "Skender Çeku" që gjendet në magjistralen Prishtinë-Pejë. Sipas pjesëmarrësve, problemi i mungesës së nënkalimeve/mbikalimeve ose të policëve të shtrirë në këtë zonë është evidentuar që një kohë të gjatë, por nuk ka pasur hapa konkrete nga strukturat udhëheqëse komunale për t'i adresuar ato. Krejt kjo po ndodhë kur niveli i ekzekutimit të shpenzimeve në këtë kategori është në 87%, duke treguar se mund të ndermirën investime shtesë – ku një pjesë e tyre do të ishin për adresimin e problemit të referuar në shkolla.

Problem tjetër i evidentuar gjatë intervistave tona është mungesa e rojeve në shkolla, shërbim i cili ka qenë në dispozicion deri para disa kohësh por që tanimë nuk ekziston. Vija buxhetore për angazhimin e rojeve të shkollave në nivelin komunal është ndërprerë, rrjedhimisht duke i lënë shkollat pa roje përderisa nxënësit vijnë në mësim. Këto gjetje janë gjithashtu në vijë me rezultatet dhe daljet nga Studimi mbi Pjesëmarrjen e Fëmijëve në Vendimmarrje 2014, ku ceket se në total, jo më shumë se 60% e shkollave ofrojnë ndonjë lloj të sigurisë në objektet e tyre, prej të cilave rreth 20% mbulohen financiarisht nga prindërit dhe familjet e nxënësve dhe pjesa tjetër mbulohet nga buxheti komunal. Duke pasur parasysh që këto shkolla janë shkolla publike, është obligim i institucioneve publike për të dhënë mbështetje financiare e që momentalisht ka një stagnim të madh në këtë aspekt.⁷⁴

Përderisa numri i masave që mund të ndermirën për të përmirësuar eksperiencën arsimore të nxënësve është mjaft i lartë, ne vazhdojmë të shohim një buxhet të alokuar në mënyrë standarde apo të ashtuquajtur 'shabllon,' ku politik bërësit i konsiderojnë investimet në ndërtesa të shkollave dhe në paga të mësuesve si investime madhore drejt përmirësimit në ofrimin të një eksperience më të mirë edukative për fëmijët.

Në anën tjetër, ekziston nevoja për një studim bazë të sektorit të arsimit që do të identifikonte nevojat e sektorit, sikurse që është duke bërë Drejtorati i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Rrjedhimisht, duke u bazuar në nevojat e fëmijëve, mësuesve dhe kushtet e identifikuar fizike të shkollave, të provohet të prioritizohen investimet në fusha të ndryshme që do të përmirësonin eksperiencën arsimore. Përderisa është bërë progres në ofrimin e arsimit universal për të gjithë fëmijët në Pejë, disa burime nga vijat buxhetore që historikisht kanë pasur performancë të dobët, mund të përdoren për trajnimin e mësuesve apo kontraktimin e psikologëve të shkollave, një problem që është elaboruar seriozisht nga pjesëmarrësit e fokus grupit. Tjetër mundësi për investim është ndërtimi i shkollëve anësore ose qasje të tjera alternative për të siguruar qasjen më të lehtë në shkolla për fëmijët me nevoja të veçanta në procesin mësimor.

Përfundimisht, për të rritur efikasitetin e buxhetit të alokuar për sektorin e arsimit, sugjerohet që të formohet një mekanizëm për raportim të shpenzimeve dhe monitorim të buxhetit, pasi që prezantimi i një procesi të buxhetimit të orientuar nga rezultatet konkrete mund të ndikoj në rritjen e efikasitetit të përdorimit të grantit specifik për arsim. Gjithashtu, ekziston një nevojë për të rritur shumën e buxhetit të alokuar për arsimimin e komuniteteve RAE dhe drejt nxitjes së arsimit gjithëpërfshirës në shkolla, duke ndjekur modele të mira praktike.

73 Perceptimi i studentëve, prindërve, dhe zyrtarëve mbi të drejtën për arsim, përqeshje, dhe diskriminim në shkolla, (2014), Syri i Vizionit and Save the Children Kosova.

74 Raporti mbi rezultatet e anketimit për të drejtën e pjesëmarrjes në vendimmarrje 2014, (2014), Save the Children Kosova.

SEKTORI I MIRËQENIES SOCIALE NË KOSOVË

Lufta kundër varfërisë së fëmijëve është bërë një shqetësim global, që shihet më mirë në faktin se gjashtë nga tetë Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit mbulojnë çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.⁷⁵ Investimet në mirëqenien sociale të fëmijëve shihen si investime me prioritet të lartë e me potencial të lartë për kthime në investimi në të ardhmen. Andaj, lind nevoja për mobilizim të aktorëve në nivel shtetëror në Kosovë drejt hartimit të politikave dhe strategjive që luftojnë direkt varfërinë të fëmijët dhe mbrojnë dinjitetin e tyre.

Në Kosovë, në nivelin lokal si dhe atë qendror, prezenca e varfërisë është shumë e lartë dhe si e tillë përfaqëson një sfidë për zhvillimin e mirëqenies sociale në vend. Sipas Agjencisë Kosovare të Statistikave, në vitin 2012, rreth 30% e popullatës jetonin në varfëri, ku 10.2% jetonin nën kufirin e varfërisë.⁷⁶ Bazuar në studimet e UNICEF, janë pikërisht fëmijët ata që preken më së shumti nga varfëria. Dëmi më i madh ju shkaktohet fëmijëve të moshës 0-14 vjeçare që jetojnë në familje me më shumë se tre fëmijë.⁷⁷ Zakonisht, familjet ku të gjithë janë të varur siç përshkruhet me ligj ata rrjedhimisht marrin asistencë sociale, dhe në ato familje mirëqenia e fëmijut ndikohet rënd.




Fig. 14 – Varfëria për kokë banori në raport me vijën kombëtare të varfërisë (% e popullsisë)

Në anën tjetër, duke u bazuar në Studimin e fundit të Fuqisë Punëtore (SFP), evidentohet se Kosova akoma përballlet me shkallë të lartë të papunësisë që arrin deri në 30%, ku edhe shkalla e ulët e punësimit është alarmuese.⁷⁸ Niveli i ultë i papunësisë është veçanërisht prezent në mesin e femrave, ku niveli i punësimit arrin vetëm 13%, përdërisa pjesëmarrja në tregun e punës arrin vetëm 20%. Një fakt shqetësues është se gati 70% e të regjistruarve si të papunë bijnë në kategorinë e kërkuesve afatgjatë të punës. Një shqetësim tjetër serioz është se rinia është e goditur rëndë nga papunësia, pasi që niveli i papunësisë në mesin e të rinjve të moshës 15-24 vjeçare është rreth 56%.

Duke pasur parasysh indikatorët ekonomik dhe social në vend, baza ligjore në Kosovë thekson se kur rrethanat janë të tilla që individët nuk kanë mbështetje nga familja, ose mbështetja nuk është e mjaftueshme për mirëqenien e individit, atëherë është përgjegjësi e shtetit që të mbështetë ata individ siç ceket në dispozitat ligjore lokale dhe qendrore.

Në nivel të vendit, mbrojtja sociale është kompetencë e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Si e tillë, ajo ka të drejtën e një kodi të veçantë buxhetor që do të ndihmonte të vlerësoheshin trendët në alokimet buxhetore ndër vite në këtë sektor. Përdërisa buxheti i konsoliduar i Kosovës ka pasur trende rritëse e njëjta nuk mund të thuhet për trendët në kategorinë e mbrojtjes sociale.

75 Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, Kombët e Bashkuara.

76 Indikatorët social, Agjencia Kosovare e Statistikave.

77 Varfëria e Fëmijëve në Kosovë, (2010), UNICEF.

78 Studimi i Fuqisë Punëtore, (2014), Agjencia Kosovare e Statistikave.

Në vitin 2014, një shumë prej pothuajse 35 milion EUR është alokuar për këtë kategori. Kjo në fakt është ndër kategoritë më buxhetin më të ultë dhe që në krahasim me buxhetin e përgjithshëm, shënon një trend zbritës. Me shkallën e varfërisë që mbetet ende shumë e lartë, këto trende zbritëse tregojnë që nuk ka një koordinim të mirë në mes të politikave dhe synimeve përfundimtare. Në mënyrë që të luftohet varfëria, alokimet momentale për mbrojtje sociale në nivelin qendror si dhe në atë lokal nuk janë të mjaftueshme, më konkretisht, ato janë të pamjaftueshme për t'i ndihmuar dhe plotësuar nevojat e përfituesve të tyre.




Fig. 15 – Buxheti për mirëqenie sociale për MPMS në Kosovë për 2010-2014

Investimet në mirëqenien sociale përbëjnë vetëm 0,83% të totalit të BPV-së në vitin 2010, përderisa ata kanë zbritur në 0.66% të BPV-së në vitin 2013. Kjo është një shifër shqetësuese që duhet të adresohet menjëherë, posaçërisht duke pasur parasysh trendët në vendet e OECD që tregojnë përkushtim më të madh financiar në këtë drejtim në vitet e fundit.

Mesatarisht, rreth 80% e fondeve të alokuara shpenzohen në skema sociale, duke lënë kështu zhvillimin e kualitetit të shërbimeve sociale mbrapa. Një tjetër trend interesant është se buxheti i Ministrisë është rritur me trende rritëse, përderisa alokimi i buxhetit për mirëqenie sociale ka pësuar trende zbritëse. Në këtë aspekt, lind nevoja për të theksuar edhe një herë problemin e kriterit të caktuar për tu kualifikuar për të marrë asistencë sociale. Përderisa në terma të përgjithshëm, numri i familjeve të regjistruar si marrës të asistencës sociale mund të ketë zbritur, kjo nuk është një përfaqësim real i gjendjes së mirëqenies sociale në vend.

Gjersa popullsia e cila jeton nën vijën e varfërisë në Kosovë është rreth 30% e totalit,⁷⁹ dhe në anën tjetër, buxheti i konsoliduar i Kosovës është duke u rritur nga viti në vit, ne nuk shohim një rritje të alokimeve të fondeve drejt sektorit të mirëqenies sociale. Shtesa e vetme në skemën sociale është kompensimi shtesë për fëmijë për familjet skamnore në shumën prej 5 eurosh që hyri në fuqi në tetor 2012.

Përderisa politikat për mbrojtje sociale hartohen në nivelin qendror, siç u cek më parë, duke u bazuar në Ligjin për Qeverisjen Lokale të vitit 2009, ka pasur një delegim të pushtetit nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale tek autoritetet lokale për një rol të definuar qartë në aspektin e ofrimit të shërbimeve sociale. Shpërndarja e shërbimeve sociale dhe familjare rregullohet përmes Drejtoratit për Shëndetësi dhe Shërbime Sociale i cili obligohet t'i respektoj standardet e caktuara nga ministria.⁸⁰ Shërbimet shpërndahen përmes Qendrës për Punë Sociale ose përmes organizatave joqeveritare që janë kompetente në këtë fushë. Drejtorati është i obliguar që të përpiloj plane zhvillimore vjetore si dhe të përgatisë raporte vjetore çdo fundvit për aktivitetet e qendrës në fushën e ofrimit të shërbimeve sociale. Duke marrë një gjë të tillë parasysh, drejtoria është e obliguar që të ketë në konsideratë nevojat e grupeve të veçanta dhe të përfituesve të drejt për drejt të asistencës sociale. Qendra për Punë Sociale është entiteti që sipas ligjit është e caktuar të ofroj shërbime sociale. Drejtori duhet të jap llogari në komunë se si fondet e alokuara janë përdorur, për-

79 Popullsia nën vijën e varfërisë, Profili i Kosovës, CIA.

80 Ligji No. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale. Kuvendi i Kosovës.

derisa, në anën tjetër, menaxhimi i skemave sociale mbetet përgjegjësi e Ministrisë së Punë dhe Mirëqenies Sociale. Mes tjerash, komunat janë të obliguara të ofrojnë shërbime familjare dhe shërbime tjera të mirëqenies sociale, siç është kujdesi për më të pambrojturit, kujdesi birësues, kujdesi ndaj fëmijëve, kujdesi ndaj pleqve, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave të kujdesit, rekrutimet, pagesën e pagave dhe trajnimeve për punëtorët profesional të mirëqenies sociale.

Është përgjegjësi e komunës që të rregulloj dhe menaxhoj nevojat buxhetore të tyre. Në rastin e përgjegjësi të deleguara, është përgjegjësi e Qeverisë që të alokoj sasinë e duhur të fondeve në Buxhetin e Konsoliduar Kombëtar që do të mbulonte shpenzimet që dalin direkt nga kompetencat e deleguara rishtazi.

Kategoritë që marrin asistencë sociale në Kosovë janë të një varieteti të gjerë dhe kryesisht janë klasifikuar duke u bazuar në kontekstin social në vend pas periudhës së luftës. Ekziston një numër i madh i programeve sociale, posaçërisht për kategoritë që janë ndikuar direkt nga lufta. Asistenca sociale për fëmijët ofrohet në pakot në vazhdim: birësim familjar për fëmijët e braktisur pa kujdes prindëror, birësim rezidencial, skema e asistencës sociale si dhe asistencë sociale për familjet me fëmije me aftësi të kufizuara permanente.

PAKETA LIGJORE QË MBRON TË DREJTAT E FËMIJËVE

Duke u bazuar në paketën ligjore që merret me mbrojtjen e fëmijëve është përgjegjësi e prindërve që t'ju ofrojnë fëmijëve të tyre të gjitha të drejtat dhe kushtet që iu nevojiten për një jetesë normale. Nëse prindërit nuk mund ta përballojnë këtë, atëherë i takon shtetit që të ndërhyjë dhe t'i marrë masat e duhura për të mbrojtur dinjitetin e atyre fëmijëve. Në këtë aspekt, ligjet për mbrojtjen sociale janë aty për t'i mbrojtur fëmijët familjet e të cilëve nuk mund të përballojnë një edukim të përshtatshëm ose mbrojtjen e fëmijëve të cilët nuk kanë përkujdesje prindërore fare. Lista e ligjeve që prekin këtë sektor është e shumëllojshme: Ligji mbi Shërbimin Social dhe Familjar; Ligji mbi Skemën e Asistencës Sociale; Ligji për Mbështetje Materiale për Familjet me Fëmije me Aftësi të Kufizuara; Ligji i Sigurisë në Punë, Mbrojtjes së Shëndetit të Punëtorit dhe e Ambientit të Punës, si dhe Ligji i Punës, Ligji mbi Inspektoratin e Punës; Ligji mbi Mbrojtjen nga Dhuna Familjare; Ligji mbi Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, dhe Veteranëve të UÇK-së, dhe Familjarëve të Viktimave të Luftës. Ideja e kësaj pakete legjislativë është të respektohet dinjiteti i fëmijut duke bërë përpjekje maksimale për të garantuar mirëqenien brenda familjeve natyrale përmes formave të ndryshme të asistencës ose mbështetjes materiale. Shfrytëzimi i fëmijëve për përfitime është i ndaluar rreptësisht, ashtu siç është edhe përdorimi i tyre për përfitim ekonomik dhe keqtrajtim.

Programi i asistencës sociale është i organizuar si në vijim:

- Ofrimi i skemës së asistencës sociale
- Ofrimi i shërbimeve sociale⁸¹

Skema e asistencës sociale është përgjegjësi e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, përderisa ofrimi i shërbimeve të asistencës sociale është kompetencë e niveleve lokale. Megjithatë, edhe pse menaxhimi i skemave sociale është përgjegjësi e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ajo ndikon direkt në mirëqenien sociale në nivelet lokale. Qendra për Punë Sociale, që operon në kuadër të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, është përgjegjëse vetëm për regjistrimin e përfituesve. Përderisa, duke u bazuar në Ligjin për Qeverisje Lokale, komunave iu është deleguar vetëm menaxhimi i shërbimeve sociale. Petrit Loci thekson se decentralizimi i pjesshëm i shërbimeve sociale nuk është efikas. Më konkretisht, nuk mund të përitet nga inspektorët e Ministrisë të mbajnë ritmin me trendet sociale në komunë siç do të bënin autoritetet kompetente brenda komunës. Duke u bazuar në menaxhimin e përzier të programit të mirëqenies sociale, ekzistojnë shanse më të mëdha për manipulime dhe keqpërdorime të fondeve.

81 Zariqi, Q., Përmbledhje e Ligjeve që Mbrojnë të Drejtat e Fëmijëve në Republikën e Kosovës, (2012).

FINANCIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE SI NJË NGA KOMPETENCAT E DELEGUARA TË KOMUNAVE

Komunat i ofrojnë shërbimet sociale përmes Qendrave për Punë Sociale që janë nën drejtimin e Drejtorive për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Mënyra se si alokohet buxheti për këto QPS mundësohet nga kombinimi i grantit të përgjithshëm dhe burimeve vetanake të të ardhurave në nivelin komunal. Zakonisht, të hyrat vetanake janë shumë të vogla në krahasim me mbështetjen financiare që vjen nga granti i përgjithshëm. Megjithatë edhe vet shuma e grantit nuk mjafton. Jeton Abazi, Drejtor në Departamentin e Financave në Komunën e Pejës thekson që granti është, siç thotë edhe vet emri, i përgjithshëm dhe si i tillë bën që departamente të ndryshme brenda komunës të luftojnë për absorbim sa më të madh të resurseve financiare në mënyrë që t'i mbulojnë shpenzimet e departamenteve të tyre. Në vijë me këtë, vet granti nuk garanton një përqindje minimale që do të alokohej domosdoshmërisht për financimin e këtyre QPS-ve.

Kjo është pjesa ku qëndrueshmëria e mbështetjes financiare për ofrimin e shërbimeve sociale në nivelet komunale kërcënohet nga sistemi momental i alokimeve buxhetore për këtë sektor konkret. Grafi më poshtë e sqaron problemin e këtij sistemi.




Fig. 16 – Trendët në alokimet buxhetore për QPS në nivelin qendror dhe atë komunal 2010-2014

Duke u bazuar në këto shifra, mund të konstatojmë se në nivelin qendror ka qenë një progres i vogël prej vitit në vit sa i përket burimeve financiare të alokuara për këto qendra. Në komunën e Pejës, luhatjet në buxhetin e alokuar për këto qendra janë pothuajse në vijë me trendët e evidentuara në nivelin qendror. Saktësisht këtu problemi bëhet madhor. Përderisa, siç tanimë është cekur, shifrat e mirëqenies sociale nuk janë përmirësuar në përgjithësi, ekziston një falsitet në marrëdhënien mes këtyre trendëve përgjithësisht në sektorin e shërbimeve sociale dhe në trendët e mbështetjes financiare në kuadër të këtij kodi buxhetor.

Forma momentale e financimit të sektorit të shërbimeve sociale nuk bazohet në një formulë strikte që do të merrte në konsiderim faktorët e ndryshëm dhe nevojat në nivelin komunal. Si e tillë, financimi i punës së QPS-ve lihet në mëshirën e udhëheqësve komunal, të cilët duke u bazuar në agjendat e tyre, sipas Jeton Abazit, mund të rrezikojnë dhe kërcënojnë qëndrueshmërinë financiare të këtyre qendrave në planin afatgjatë për shkak të investimeve në fusha tjera. Përderisa nuk ka politika të reja për të garantuar nivel minimal të përkrahjes financiare për këto qendra, ekziston rreziku që niveli i ulët i financimit mund të ndikoj negativisht në kualitetin e ofruar në këto qendra. Kjo si rrjedhojë mund të rrezikoj operimin e këtyre qendrave të cilat mund t'i ekspozohen rrezikut të mbylljes të urdhëruar nga niveli qendror për shkak të mungesës së shërbimeve cilësore që ofrohen nga ato.

TRENDËT E PËRGJITHSHME TË FINANÇIMIT NË KOMUNËN E PEJËS

Tabela më poshtë ofron një vështrim të qartë të trendëve buxhetore për sektorin e mbrojtjes sociale në Komunën e Pejës duke filluar nga viti 2010 deri në vitin 2014. Duke u bazuar në këto shifra, në vitin 2014 kanë qenë 180,000 EUR të alokuara për këtë sektor. Përderisa, skema sociale mbulohet nga niveli qendror, alokimi i kësaj sasive të parave, i cili përbën vetëm 1% të buxhetit total të Komunës së Pejës për këtë vit është pothuajse absurd dhe pa dyshim që nuk i plotëson nevojat e sektorit. Për më shumë, vlen të përmendet fakti që ka pasur zbritje të fondeve të alokuara për këtë sektor këtë vit në krahasim me vitin e kaluar. Në vitin 2013, buxheti për ofrimin e shërbimeve sociale ishte 213,500 EUR, që është 11% më i lartë në krahasim me nivelet momentale. Për më shumë, gati 50% e buxhetit momental është alokuar për rroga. Fondet e mbetura janë të shpërndara në mënyrë gati të barabartë në mes të kategorive të Mallrave dhe Shërbimeve, Transfereve dhe Subvencioneve Sociale, si dhe Investimeve Kapitale.

VITI		PAGAT DHE MËDITJET	% E BUXHETIT TOTAL	TË MIRAT DHE SHËRBIMET	% E BUXHETIT TOTAL	SHËRBIMET KOMUNALE	% E BUXHETIT TOTAL	TRANSFERE DHE SUBVENCIONE	% E BUXHETIT TOTAL	SHPENZIMET KAPITALE	% E BUXHETIT TOTAL	TOTAL
2010	PLAN	72,008.16										
	EX.	72,007.81	59.08%	10,038.07		9,469.29		29,800.00		0		121,315.17
	%	100%		99.99%		96.28%		99.33%				99.53%
2011	PLAN	69,148.00		12,056.00		9,200.00		0		0		90,405.00
	EX.	69,126.77	76.49%	12,055.79	13.34%	9,179.68	10.18%	0	0%	0	0%	90,362.24
	%	99.97%		100.00%		99.78%		0%		0%		99.95%
2012	PLAN	78,763.00		35,000.00		9,000.00		30,000.00		50,000.00		202,763.75
	EX.	78,762.97	38.84%	34,955.98	17.26%	8,998.69	4.44%	29,970.00	14.80%	15,000.00	24.66%	167,687.64
	%	100.00%		99.87%		99.99%		99.90%		30.00%		82.70%
2013	PLAN	86,000.00		65,300.00		7,200.00		30,000.00		25,000.00		213,500.88
	EX.	85,677.35	40.28%	65,280.84	30.59%	7,192.58	3.37%	29,980.00	14.05%	25,000.00	11.71%	213,130.77
	%	99.62%		99.97%		99.90%		99.93%		100.00%		99.83%
2014	PLAN	86,000.00		35,300.00		6,500.00		30,000.00		30,000.00		187,800.84
	EX.	N/A	45.79%	N/A	18.80%	N/A	3.46%	N/A	15.97%	N/A	15.97%	N/A
	%	N/A		N/A		N/A		N/A		N/A		N/A

■ Fig.17 – Buxheti i Planifikuar dhe i Ekzekutuar për secilën kategori buxhetore në sektorin e Mirëqenies Sociale në Komunën e Pejës

Vlen të përmendet se duke u bazuar në raportin e shpenzimeve, mund të identifikohet lehtë se realizimi i buxhetit ka qenë gati në nivelin 100% në secilën kategori, përveç në vitin 2012, ku vetëm 30% e buxhetit të planifikuar është menaxhuar në mënyrë të suksesshme. Kjo në shikim të parë tregon se alokimi i buxhetit për këtë sektor bazohet në planifikim thelbësor dhe se i kushtohet vëmendje e veçantë gjatë periudhës së planifikimit buxhetor. Megjithatë, duhet edhe njëherë t'i kthehemi faktit që buxheti i alokuar në këtë sektor është minimal, rrjedhimisht nuk lejon një zgjerim ose përmirësim të mëtutjeshëm të shërbimeve të ofruara në QPS.


Skema e asistencës sociale

Skema e asistencës sociale është njëra nga masat më të gjëra të mbrojtjes sociale që ka për synim të luftoj direkt nivelet e varfërisë në vend duke ofruar një lloj asistence sociale për ata që jetojnë në varfëri.

Skema e asistencës sociale rregullohet përmes Ligjit për Skemën e asistencës Sociale, i cili bazuar në Nenin 4 specifikon një numër të caktuar të kriterëve që familjet dhe fëmijët në nevojë duhet ti plotësojnë në mënyrë që të kualifikohen për këtë skemë.

- Së pari, aplikanti për skemë sociale duhet të jetë banorë i Republikës së Kosovës dhe në mënyrë që aplikanti të kualifikohet për përfitimin e kësaj asistence financiare ai/ajo duhet të bie në njërin nga grupet në vijim:
- Asnjë anëtarë i familjes nuk punon ose nuk është i aftë për të punuar

Një anëtarë i familjes punon, por është i regjistruar si i papunë dhe e ka të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeçare nën përkujdesje ose një fëmijë jetim nën moshën 15 vjeçare.⁸²



■ Fig. 18 – Numri i familjeve që fitojnë asistencë sociale në Komunën e Pejës

Sikurse me trendët në nivelin qendror, numri i familjeve që janë përfituese të skemës sociale në Pejë është zvogëluar ndër vite. Përderisa në vitin 2010 ishin 1,563 familje që merrnin asistencë sociale, numri në vitin 2013 ka rënë në 1,333. Duke folur me përqindje, është një përparim gati prej 15% në numrin e familjeve në nevojë dhe përfituesve të skemës sociale në komunën e Pejës. Fakti që numri i familjeve që marrin asistencë sociale është zvogëluar nuk është indikator i përmirësimit të mirëqenies sociale në Komunën e Pejës ose në përgjithësi në vend. Arsyeja kryesore pas këtij përmirësimi të numrave është për faktin se

82 Ligji No. 2003/15 mbi Skemën e Asistencës Sociale në Kosovë. Kuvedi i Kosovës.

shumë familje nuk i kanë plotësuar kriteret e caktuara me ligj për të qenë përfitues të skemës së asistencës sociale. Shumë studime, duke përfshirë studimin e UNICEF-it mbi varfërinë e fëmijëve në 2010⁸³ e kanë kritikuar kriterin e parë të kategorisë së dytë, ku familja kualifikohet për asistencë sociale vetëm nëse ka një fëmijë nën moshën 5 vjeçare. Kjo bën thirrje për ndryshimin e këtij neni të ligjit, konkretisht sepse, në vend se të përmirësoj kushtet sociale në vend, ky kriter në fakt është duke kontribuar në përhapjen e shkallëve më të larta të varfërisë. Naser Lajqi nga Syri i Vizionit thekson që ky kriter ka krijuar një tendencë tek shumë familje që kur fëmijët arrijnë moshën 5 vjeçare, të lindin fëmijë vetëm që të mos përjashtohen nga skema. Kjo nuk po i ndihmon familjet të përmirësojnë kushtet sociale, përkundrazi është duke kontribuar drejt përkeqësimit të mirëqenies dhe ngritjes së kostos së jetesës për ata.

Për më shumë, shuma mesatare prej 65 EUR për familje e dhënë në formë të asistencës sociale në përgjithësi shihet si e pamjaftueshme. Argumentohet se kjo shumë e të hollave nuk i përgjigjet rrethanave ekonomike në vend dhe si e tillë nuk shihet si një mënyrë efiçase për të luftuar reduktimin e varfërisë në përgjithësi dhe të varfërisë tek fëmijët në veçanti.

Ligji mbi Skemën e Asistencës Sociale në Kosovë ofron krijimin e skemës së sigurimeve sociale për familjet që jetojnë në varfëri, familjet që ballafaqohen me vështirësi të caktuara dhe të cilat kanë nevojë për asistencë. Asistenca financiare i ofrohet familjeve në bazë të vërtetimit të pasurisë dhe gjendjes sociale, përderisa skema si e tillë administrohet nga MPMS përmes Qendrave për Punë Sociale.

- Në Nenin 9 të Ligjit për Skemën e Asistencës Sociale përcaktohet shkalla mujore standarde e kompenzimit financiar për asistencë sociale. Kjo shkallë rregullohet varësisht nga numri i anëtarëve të familjes dhe numri i pikëve për anëtarë siç është e prezantuar më poshtë:
- Familjet me 2 anëtarë – 50 EUR
- Familjet me 3 anëtarë – 55 EUR
- Familjet me 4 anëtarë – 60 EUR
- Familjet me 5 anëtarë – 65 EUR
- Familjet me 6 anëtarë – 70 EUR
- Familjet me 7 anëtarë – 75 EUR⁸⁴

Siç mund të shihet, me këtë përcaktim të shkallës së mbështetjes financiare mujore, shteti është duke dështuar që t'i ofroj secilit fëmijë të drejtën e një standardi adekuat të jetesës. Dihet se me këtë shumë të caktuar mujore, fëmijët nuk mund t'i ushtrojnë as të drejtat e tyre elementare e lëre më të kenë një standard adekuat të jetesës që do tu siguronte mbijetesën, zhvillimin dhe sigurinë sociale. Rrjedhimisht, Qeveria e Republikës së Kosovës brenda mundësive që i ka, duhet t'i kushtoj vëmendje më të madhe rritjes së burimeve mbështetëse financiare për siguri sociale në mënyrë që t'i mundësoj çdo fëmiju një standard adekuat të jetesës, posaçërisht në lidhje me ushqimin, veshmbathjen, dhe strehimin.

Mbështetja e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara

Ligji për Mbështetjen Materiale të Familjeve me Fëmijë me Aftësi të Kufizuara është mënyra më efektive që Qeveria ka zgjedhur për të adresuar direkt çështjen e mbështetjes sociale për familjet që rrisin fëmijë me kufizime të ndryshme fizike dhe mendore. Si i tillë, ligji parashih që këto familje do të përfitojnë 100 EUR në muaj. Pa marrë parasysh faktin se në shikim të parë kjo paketë mund të konsiderohet si njëra ndër politikat më të mira deri më tani, ligji mbulon vetëm fëmijët që janë të hendikepuar përgjithmonë dhe si i tillë i përjashton ata të cilët mund të kenë hendikepe të rënda por që nuk klasifikohen si permanente sipas ligjit.

Fëmijët me hendikepe të përhershme janë ata të cilët janë ose të palëvizshëm, totalisht të verbër, dhe fëmijët të cilët për shkak të natyrës së sëmundjes ose sëmundjes së përhershme nuk janë në gjendje të lëvi-

83 Studim i nivelit të varfërisë të fëmijët në Kosovë, (2010), UNICEF.

84 Ligji No. 2003/15 mbi Skemën e Asistencës Sociale në Kosovë. Kuvedi i Kosovës.

zin vetë në mënyrë të pavarur në vendet që ata kanë nevojë, nuk janë në gjendje të hanë vet, të veshën dhe zhveshën për të kryer nevojat e veta fiziologjike si dhe të mbajnë higjienën personale.

Grafika më poshtë ofron shifrat e fëmijëve përfitues të kësaj kategorie dhe koston financiare që del nga mbështetja e familjeve të këtyre fëmijëve.




Fig. 19 – Numri i përfituesve dhe kostot e skemës

Në vitin 2014, duke u bazuar në statistikat e çerekut të tretë të ofruara nga Agjencia Kosovare e Statistikave, numri i familjeve në Kosovë që kanë marrë mbështetje financiare ka qenë 126.

Strehimi familjar

Një tjetër obligim i Qendrës për Punë Sociale është të marrë rolin e prindit të përgjegjshëm për fëmijët të cilët janë jetim, janë të braktisur nga prindërit e tyre, kanë probleme brenda familjes, i kanë prindërit e divorcuar etj. Hapi i parë i ndërmarrë në këto rrethana është që QPS-të marrin rolin e kujdestarit deri sa të gjendet një zgjidhje që është e përshtatshme dhe garanton mirëqenien dhe mbrojtjen e dinjitetit të fëmijut.

- Janë tri alternativa për kujdestari për këta fëmijë në nevojë:
- Kujdestaria në rrethin e ngushtë familjar
- Kujdestari tek një familje që është e gatshme të ofrojë strehim për një fëmijë
- Kujdestari rezidenciale⁸⁵

Është përgjegjësi e QPS-së që të sigurohet që së pari të gjitha mundësitë për kujdes në familje janë shterur. Më pastaj qendra bashkë me OJQ-të bashkëpunuese është përgjegjëse për trajnimin e familjeve kujdestare dhe për të përputhur nevojat e fëmijut me familjen e cila është e gatshme t'i ofrojë strehim këtyre fëmijëve.

Siç u cek, së pari të gjitha format e kujdesit familjar duhet të shteren, në fillim brenda rrethit të ngushtë familjar e pastaj tek rrethi i gjerë familjar, e më pastaj te familjet strehuese. Akti përfundimtar duhet të jetë vendosja e fëmijëve në qendrat rezidenciale të kujdesit.

Mbështetjet financiare për këto lloje të përkujdesit janë si në vijim: 75 EUR për fëmijë nëse fëmiju është duke qëndruar me dikë nga rrethi familjar; 150 EUR për familjet që ofrojnë kujdestari; dhe 250 EUR për fëmijët që ofrojnë kujdestari për fëmijët me nevoja të veçanta.

85 Ligji No. 02/L-17 mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare, Kuvendi i Kosovës.

Momentalisht në Pejë janë 11 fëmijë që u ofrohet përkujdesje rezidenciale në institucione të ndryshme dhe 7 fëmijë që i është dhënë përkujdesje familjare tek familjet kujdestare ose tek të afërmit.

DEDIKIMI I LIMITUAR I SHËRBIMEVE SOCIALE PËR MIRËQENIEN E FËMIJËVE NË KOMUNËN E PEJËS

Kosova vuan nga një numër problemesh në sistemin e mirëqenies sociale. Ç'është më e rëndësishmja, ka akoma mungesë të të dhënave mbi të cilat do të mund të bëheshin zgjedhjet e politikave duke u bazuar në fakte. Për më shumë, ka një koordinim të dobët horizontal dhe vertikal, një përplasje mes qeverisjes teknike dhe politike, dhe mungesë e përfshirjes së palëve të interesit në debatin publik, planifikim dhe buxhetim të shërbimeve sociale. Si pasojë, kuptojmë që decentralizimi i shërbimeve dhe i financave mund të ketë qenë i ngutshëm për arsye politike pa diskutime të mjaftueshme rreth implikimeve që mund të kishte ky proces për përfshirje të barabartë në vendimmarrje. Mungesa e debatit publik dhe participimit në të është një problem i madh, e cila gjë përfundimisht i ndikon negativisht shfrytëzuesit e shërbimeve sociale. Përkushtimet ligjore ndaj adresimit të problemeve gjinore, etnike dhe çështjes së varfërisë ekzistojnë, mirëpo problem është implementimi i tyre. Politikat për adresimin e problemeve të fëmijëve janë deficitare, qoftë në ndërhyrjet e nevojshme në stadin e hershëm të zhvillimit të tyre qoftë në aspektin e krijimit të masave për luftim të varfërisë tek ata. Përderisa reformat pensionale, asistenca mjekësore dhe sociale duket të jenë prioritete, asnjëra nga këto nuk i janë përshtatur nevojave të fëmijëve. Përfundimisht, një strategji e përgjithshme për përfshirje sociale është e mangët dhe deri me tani ka pas ndikime të vazhdueshme dhe asistencë konstante nga agjencitë ndërkombëtare në zhvillimin e politikave dhe projekteve në sektorin e mirëqenies sociale.

Programet e mirëqenies sociale të orientuara kah fëmijët janë të mangëta edhe në Komunën e Pejës. Të drejtat e tyre në këtë aspekt kryesisht mbrohen nga prindërit. Me fjalë të tjera, niveli i pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje kur bëhet fjalë për fatin e tyre mbetet mjaft i ultë. Kjo është në përputhshmëri të plotë me gjetjet e anketës 'E drejta e pjesëmarrjes në vendimmarrje' e realizuar nga Save the Children në Kosovë në vitin 2014. Bazuar në të gjetuar e këtij raporti, është evidentuar që fëmijët ndihen mjaft të limituar në pothuajse çdo aspekt në ciklin e vendimmarrjes. Së pari, vetëm 5% e fëmijëve kanë deklaruar se janë të lirë për të vendosur vet për klasat që dëshirojnë të vijnë, vetëm 1% e të intervistuarve kanë deklaruar që ju jepet e drejtë të shprehin mendimin e tyre kur familja blen diçka të rëndësishme për shtëpi, përderisa 50% kanë deklaruar se nuk ju jepet mundësi të shprehin preferencat e tyre kur përzgjidhet Udhëheqësia e Nxënësve në klasë. Këto shifra dëshmojnë që e drejta dhe pjesëmarrja e fëmijëve në vendimmarrje në Kosovë është shumë e ultë dhe kjo vlen edhe për të drejtat e tyre në sektorin e mirëqenies sociale.

Momentalisht, bashkimi i shërbimeve të shëndetësisë dhe atyre sociale nën një menaxhment të vetëm mund të ketë implikime negative për zhvillimin e programeve të mirëqenies sociale në aspektin e mundësisë së tyre për t'ju përgjigjur nevojave specifike të qytetarëve e në veçanti të fëmijëve. Duke u bazuar në trendet buxhetore, mund të vërehet se buxheti i alokuar për Qendrën për Punë Sociale që operon në Pejë nën menaxhimin e kësaj drejtorie nuk është shumë i duhur dhe duket se është kopjuar dhe bartur nga njëri vit në tjetrin. Buxheti momental i alokuar për këtë sektor është i pamjaftueshëm. Rrjedhimisht, pikë së pari është e nevojshme që të dizajnohet një grant për të garantuar ofrimin e një kualiteti minimal të shërbimeve të ofruara ose të paktën të caktohet minimumi që duhet të alokohet për vijën buxhetore të mirëqenies sociale.

Në anën tjetër, mentaliteti në komunë është i tillë që përdorimi i shërbimeve sociale të atribuon një etiketim social negativ dhe se mirëqenia sociale implikon vetëm transfere sociale dhe skema sociale. Përderisa momentalisht në Pejë është duke operuar Qendra për Kujdes të Veçantë si një degë e veçantë e QPS, financimi i kësaj qendre është i shkurtuar drastikisht. Është pikërisht funksionimi i plotë operacional i kësaj qendre që do të ndihmonte shumë në aspektin e ofrimit të ndihmës sociale për të rinjtë që kanë probleme me sistemin e drejtësisë ose kanë kryer ndonjë keq bërje.

Momentalisht në Pejë, qyteti ka problem të madh me një grup fëmijësh të cilët po i ekspozojnë qytetarët ndaj trazirave të përditshme dhe po bëjnë krime të vogla, përderisa Ligji nuk ka dispozita për ta mbuluar këtë grup moshe dhe nuk ka ndonjë masë për t'i ekspozuar ata ndaj sistemit të drejtësisë. Duke pasur një mekanizëm të instaluar tashmë, siç është Qendra për Kujdes të Veçantë, që do të ndihmonte në adresimin e këtij problemi, ka nevojë për një alokim direkt të fondeve që do të mbështesnin funksionalizimin e saj. Në këtë aspekt, ka nevojë që të garantohet një buxhet i ndarë për shpërblimin e punëtorëve që punojnë me orar të plotë në këtë qendër e që momentalisht praktikisht ata punojnë në bazë vullnetare.

Përderisa ekziston një tendencë e tillë që shërbimet sociale keqkuptohen nga qytetarët, lind nevoja për mobilizim të shoqërisë që mbrojtja sociale nuk implikon vetëm mbështetje financiare dhe si rrjedhojë të promovohen benefitet që lindin nga përdorimi shërbimeve sociale të menaxhuara në nivel lokal. Për të bërë këtë, duhet që të vazhdohet procesi i verifikimit të OJQ-ve që veprojnë në këtë fushë, pasi që ata do të mundësonin përmirësimin e shërbimeve të ofruara duke marrë parasysh që ka mungesë të personelit të kualifikuar në institucionet shtetëror si pasojë e mungesës së mbështetjes financiare.

Përfundimisht është e nevojshme që të krijohet një bazë e të dhënave në nivel komunal për të regjistruar numrin e familjeve në nevojë si dhe numrin e saktë të fëmijëve në secilën kategori në mënyrë që të jemi në gjendje të hartojmë politika gjithëpërfshirës sociale në nivelin lokal. Për momentin, shumica e programeve dhe skemave sociale nuk i përshtatet nevojave të fëmijëve, përderisa nuk ka fare buxhetim për shërbime sociale për komunitete. Rrjedhimisht është e nevojshme që të zhvillohet një strategji koherente për definimin e roleve në fushën e mirëqenies sociale, ku rolet e akterëve të ndryshëm, funksionet e tyre dhe mundësitë për financim do të ishin të definuara në mënyrë sa më të qartë.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Duke u bazuar në analizat fiskale dhe alokimet buxhetore në nivelin qendror si dhe atë lokal, ne i kemi identifikuar problemet më të mëdha, trendët e vazhdueshme, efikasitetin e financimeve publike, dhe çështjet që ndërlidhen me menaxhimin ekzistues dhe alokimin momental të burimeve financiare. Problemet e evidentuara gjatë studimit lidhen me faktin që menaxhimi i fondeve publike është një fushë e rregulluar nga ligjet në mënyrë strikte, formula të definuara qartë, dhe ka tendencë të jetë i orkestruar nga agjendat politike, siç është rasti i rritjes së pagave të shërbyesve civil. Në mungesë të potencialit për ndryshime madhore në këtë drejtim, raporti do të përmbillet me një sërë rekomandimesh dhe alternativash që mund të ndihmojnë në këtë drejtim dhe që përfundimisht do të ishin më shumë të përshtatura nevojave të qytetarëve të Pejës.

Të gjeturat kryesore të këtij raporti janë:

- Siç është cekur qartë shumë herë përgjatë këtij raporti është fakti që **ekziston një sistem i decentralizuar i menaxhimit të tre sektorëve shumë të rëndësishëm, atij të shëndetësisë primare, arsimit para universitar, dhe ofrimit të shërbimeve sociale, që direkt ndikojnë në mirëqenien e fëmijëve** në përgjithësi në Kosovë dhe në Komunën e Pejës në veçanti. Prosesi i decentralizimit si i tillë shihet si mënyrë e mirë për të rritur llogaridhënien e institucioneve kryesore ndaj qytetarëve përderisa ofron një shans për qytetarët për të arritur nivele më të larta të pjesëmarrjes në vendimmarrje.
- Sa i përket buxhetimit të nevojave të fëmijëve dhe reflektimit të këtyre nevojave në programet e udhëheqjes lokale, pak veprime pozitive mund të identifikohen deri më tani. Përderisa decentralizimi është duke ndodhur si proces i pavarur, **nuk ka pasur ndonjë përparim në aspektin e reflektimit të nevojave të fëmijëve në buxhetin qendror dhe atë lokal.**
- Kur qarkorja buxhetore arrin Departamentin e Financave të Komunës së Pejës, konkurrenca në mes të departamenteve të ndryshme bëhet e egër me qëllim të absorbimit të sa më shumë fon-

deve për departamentet e ndryshme. Sigurisht ka shume kërkesa konkurruese për fonde lokale, rrjedhimisht trupat lokale përballen me vendime të vështira se si t'i përdorin këto resurse. Si e tillë, **në mungesë të politikave të definuara qartë dhe caqeve të definuara buxhetore, buxheti për fëmijët shteret përkrah investimeve në fushat tjera me prioritet që potencialisht sjellin më shumë poenë politike dhe vota për politik bërësit.**

- Normalisht, për hartimin e një plani buxhetor për një vit të veçantë fiskal, komunat janë të obliguara siç ceket me ligj të mbajnë dëgjime publike me qytetarët në mënyrë që t'i dëgjojnë shqetësimet e tyre dhe t'i inkorporojnë ato në vijat buxhetore. Duke u bazuar në intervistat që ne kemi bërë me krerët e departamenteve komunale, kemi arritur të kuptojmë se përkundër faktit që Komuna e Pejës është e përkushtuar që t'i respektoj obligimet ligjore, përgjigja e qytetarëve ka qenë gati indiferente. Drejtori i Drejtorisë për Financa në Komunën e Pejës qartësoj se **përkundër faktit që janë organizuar 6 mbledhje në 6 rajone të ndryshme brenda komunës, pjesëmarrja e qytetarëve dhe interesimi për të marrë pjesë në to ka qenë i vogël.**
- Qytetarët e ngritin zërin dhe shqetësohen për çështjet e luftimit të niveleve të varfërisë dhe krijimit të mundësive për punësim, andaj nuk ka pasur mungesë të kërkesave për investime specifike në fusha të ndryshme që do të përmirësonin jetët e qytetarëve, si për shembull investime në rrugë, furnizim me ujë dhe kanalizime, etj. Përderisa këto investime në fakt kontribuojnë në një dozë në mirëqenien e fëmijëve, **është e nevojshme që të bëhet mobilizim dhe koordinimi i përfaqësuesve të fëmijëve dhe organizatave që luftojnë për të drejtat e tyre në mënyrë që agjendat e tyre të shtyhen përpara.**
- Çka ne ishim në gjendje të identifikojmë gjatë hulumtimeve tona në terren dhe nga tavolina është se ka pothuajse një mungesë totale të vizibilitetit të të drejtave të fëmijëve në planifikimet buxhetore dhe agjendat e udhëheqësve komunal.
- Ka një mungesë të veprimit kolektiv dhe shpirtit të bashkëpunimit në mes të institucioneve përgjegjëse. Po ashtu, organet lokale nuk duket se janë të interesuara që të kalojnë përtej detyrave të tyre të përditshme, me fjalë të tjera, **ka mungesë të vullnetit për të marrë iniciativa të cilat në një farë mënyre do të ndihmonin drejt bërjes së të drejtave të fëmijëve një prioritet brenda agjendës qeverisëse në nivelet lokale.**
- Pjesë e problemit është **mungesa e programeve vetdijësuese të dizajnuara për polit bërësit në mënyrë që t'i bëjnë ata të kuptojnë benefitet afatgjata të investimit në fëmijë.** Një problem tjetër është përhapja e varfërisë dhe përhapja e këtij fenomeni në shoqëri. Përderisa luftimi i varfërisë shihet si një ndër fokuset kryesore të Qeverisë dhe qeverive lokale gjithashtu, politikat janë të fokusuara të luftojnë shkallën e papunësisë dhe të mundësojnë rritjen mundësive për punësim. Ky veprim mund të identifikohet si shkurt pamës në krahasim me investimin në fëmijë përmes skemave të programeve sociale dhe programeve tjera të përshtatshme që do të reduktonin barrën financiare të vijimit të mësimin dhe do të zgjeronin mundësitë për qasje universale në shërbimet mjekësore.
- Për më shumë, çka ne mund të kuptojmë është se **aranzhimet e politikbërjes në nivel lokal kanë tendencë që të koordinohen me synimet dhe strategjitë e nivelit qendror.** Në shikim të parë kjo nuk duhet të paraqes një problem në rast se autoritetet lokale do të bënin një përpjekje për të shkuar përtej kufijve në aspektin e ndërmarrjes së veprimeve specifike në nivelin komunal dhe të dizajnojnë programe që do t'i përgjigjeshin nevojave të qytetarëve. Rastet e këtyre veprimeve po shihen tani në Komunën e Prishtinës, ku njëri nga projektet më të mëdha është ndërmarrë më iniciativën e kryetarit dhe ka për qëllim që të ofroj një shujtë për të gjithë fëmijët që ndjekin mësimin. Nevoja për iniciativa të tilla është përshëndetur nga pjesëmarrësit në fokus grup, të cilët shprehën gatishmëri të shtyjnë përpara idenë e **nevojës së menjëhershme**

për të ndërmarrë iniciativa dhe veprime në nivel lokal e që shkon përtej asaj se çka është planifikuar dhe paraparë me planifikimin dhe strategjitë në nivel qendror.

Njësitë lokale duhet koordinohen mes veti për të krijuar një sistem stabil të statistikave dhe të dhënave që do t'i ndihmonin autoritetet lokale që të planifikojnë dhe veprojnë në pajtim me to. Mungesa e komunikimit dhe bashkëpunimit mes politik bërësve dhe qytetarëve sjellë rezultate jo të kënaqshme në lidhje me promovimin e interesave të veçanta grupore, në këtë rast, nevojat e fëmijëve.

- Përderisa grupet e fokusit konkretisht përmendën interesin e politik bërësve të rinjë të qeverisë të angazhohen në probleme ditore të institucioneve që ata përfaqësojnë, ata treguan qartë që kjo praktikë nuk është bërë më herët. Në mungesë të një lidhje mes qytetarëve dhe politik bërësve, tendenca për tu larguar nga politikat e planifikuara dhe orkestruara nga qendra shihet si një synim i paarritshëm. Momentalisht në komunë, si dhe gjithë vendin, praktika është e tillë që lidhja më e qasshme për qytetarët që t'i kanalizojnë problemet e tyre është përmes OJQ-ve që merren me të drejtat e tyre, në këtë rast, specifikisht me të drejtat e fëmijëve. Përderisa decentralizimi duhet t'i sjellë politik bërësit më afër qytetarëve, kjo nuk ka ndodhur deri më tash. Ky fenomen është në vijë më kritikuesit e decentralizimit të cilët cekin se **në mungesë të një mekanizmi të llogaridhënies dhe transferimit real të pushtetit, inkorporimi i nevojave të popullatës në ciklin e politikbërjes ka pak gjasa të ndodhë.**
- Problemet megjithatë nuk janë vetëm me politik bërësit, problemi qëndron edhe në nivelin e vetëdijes rreth investimit në të drejta të fëmijëve nga ana e qytetarëve. Kur u pyetën për iniciativat potenciale ose projekte potenciale që do të rritnin mirëqenien e fëmijëve dhe si e tillë kushtet e përgjithshme në institucione që pjesëmarrësit e fokus grupit përfaqësonin, kishte artikulime dhe përgjigje të dobëta rreth pyetjes. Me këtë kemi kuptuar që vet **drejtorët e shkollave dhe kopshteve, mësuesit, përfaqësuesit e komuniteteve, etj., nuk janë në dijeni të plotë për kornizën ligjore që ata do të mund të përdornin për të përmirësuar rrethanat në institucionet e tyre, masat, dhe kanalet që do të mund t'i përdornin për t'i arritur qëllimet e tyre.**

ZGJIDHJET E ZBATUESHME PËR TË RRRITUR SHPENZIMET NË NIVEL LOKAL PËR PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Në mënyrë që të garantohet një reflektim më i mirë i nevojave të fëmijëve dhe një promovim më i madh i të drejtave të fëmijëve, jo vetëm në planifikimin buxhetor lokal, por edhe për t'i bërë ato prioritet thelbësor në politikbërjen lokale, aktivitetet e propozuara në vijim do të mund të ndihmonin në këtë drejtim:

Rritja e vetëdijes duke shënjestruar zyrtarët publik dhe anëtarët e asamblesë lokale që i përkasin gjinisë femërore – është bërë praktikë tanimë që për të zgjidhur një problem duhet të ngritët vetëdije rreth problemit në mënyrë që çështja të çohet në një nivel ku problemi bëhet pjesë e diskursit shoqëror. E njëjta vlen për rastin në fjalë. Në mënyrë që të shohim një buxhetim të fokusuar nga fëmijët në vitet në vazhdim, duhet të sigurohemi që njerëzit që kanë përgjegjësinë për hartimin e buxhetit si dhe ata që e miratojnë atë të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë dhe implikimet pozitive të shpenzimeve të fokusuara drejt fëmijëve. Në këtë aspekt, një nga masat për të zgjidhur problemin është ngritja e vetëdijes rreth çështjes mes zyrtarëve publik që kanë përgjegjësinë për hartimin e buxhetit në nivelin lokal. Një nga masat më efektive të ndërmarra në këtë nivel është:

Të punohet me Asamblistët femra në Kuvendin Komunal të cilat shihen si alternativa më e mirë për t'i kanalizuar nevojat e fëmijëve në Asamblenë Lokale si dhe për të gjetur mënyra për t'i inkorporuar dhe reflektuar ato në buxhetet komunale.

Përkrah kësaj, **stimulimi i zyrtarëve lokal për t'i përmirësuar shërbimet për fëmijët në praktikë** është esencial, pasi që ata kanë përgjegjësi për të implementuar programet e Qeverisë. Programet trajnuese duhet të hartohen duke u bazuar në praktikat më të mira në fushën e të drejtave të fëmijëve që implementohen në vendet që janë të ranguar më lartë në këtë aspekt.

Trajnime avokimi për mbrojtësit e të drejtave të fëmijëve – Avokimi shihet si një ndër mjetet më moderne dhe momentalisht shumë të suksesshme që përdoret nga grupe të ndryshme të interesit për të shtyrë para agjendat e tyre. Në mënyrë që të rritet efikasiteti i punës së OJQ-ve që për momentin po punojnë për promovimin e të drejtave të fëmijëve, si dhe grupet e komuniteteve pakicë të cilat qëndrojnë për promovimin e interesit më të mirë për këtë pjesë të marginalizuar të shoqërisë, ka nevojë për

Mobilizim dhe koordinim të menjëhershëm të avokatëve që mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Duke bërë këtë, fokusi duhet të jetë në trajnimin e tyre dhe ofrimin e aftësive të nevojshme për avokim që do t'ju ndihmonin atyre për t'i arritur politik bërësit, dhe përmes fuqisë së tyre, të sigurohen që të drejtat e fëmijëve të reflektohen në buxhetin përfundimtar duke dizajnuar programe të ndryshme vertikale të fokusuara për mbrojtjen e nevojave të fëmijëve.

Programe për ngritje të vetëdijes për qytetarët – Momentalisht, promovimi i të drejtave të fëmijëve në komunën e Pejës është lënë nën mëshirën e OJQ-ve puna e të cilave është e fokusuar në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Megjithatë, veprimet e OJQ-ve vetëm nuk mjaftojnë. Gjatë hulumtimit, ne gjithashtu kemi gjetur veten në situata të tilla ku qytetarët e rëndomtë nuk e kanë ditur se në çfarë mënyra mund të shtyjnë qeverinë për të përmirësuar veprimet publike dhe investimet në fëmijë. Rrjedhimisht, ne kuptojmë se ka nevojë për

Programe që rrisin vetëdijen e qytetarëve rreth implikimeve pozitive të shpenzimeve të rritura për fëmijët. Ky është një vështrim i rëndësishëm sepse do të thotë që ka pak përkrahje nga qytetarët për të shtyrë përpara agjendën e orientuar drejt fëmijëve. Prandaj, programe senzibilizuese për rëndësinë e investimit në fëmijë dhe për të treguar se si ky investim rezulton në kthime të mëdha është më se i nevojshëm. Kjo përfundimisht do të ndikonte në rritjen e kërkesës nga qytetarët drejt politik bërësve lokal për të punuar më intensivisht në këtë drejtim.. Sa më herët që kjo të bëhet prioritet, aq më shpejtë do të shohim përparim në aspektin e reflektimit të nevojave të fëmijëve në vijat buxhetore të buxheteve lokale.

Integrimi i fëmijëve në vendimmarrje – Në procesin e ngritjes së vetëdijes, inkorporimi i vet fëmijëve në proces është i një rëndësie të madhe. Rrjedhimisht, lind nevoja për të identifikuar mundësi për të garantuar pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje si dhe të krijohen mënyra se si të kanalizohen zëri dhe nevojat e tyre. Një mënyrë për ta bërë këtë është:

Mobilizimi i nxënësve në nivel të shkollash. Në minimum, mbajtja e takimeve vjetore në mes të drejtorëve të shkollave, prindërve, përfaqësuesve të komunës dhe nxënësve mund të jetë një mënyrë shumë efektive për të integruar fëmijët në ciklin e politikbërjes dhe gjithashtu t'i bëjmë ata që të marrin përsipër mbrojtjen e të drejtave të tyre. Përderisa jo të gjithë fëmijët vijnë në mësim, modalitete për të inkorporuar edhe zërin e atyre që se kanë këtë mundësi do të duhej të identifikohen.

Rritja e bazës financiare – Siç u shpjegua më herët, buxhetet lokale përbëhen nga grantet specifike dhe të përgjithshme, të hyrat vetanake si dhe ndihmat ndërkombëtare. Përderisa ka pak fleksibilitet për të ndryshuar shumicën e vijave buxhetore që vijnë përmes granteve të orkestruara nga niveli qendror, dhe në anën tjetër, duke pasur parasysh nivelin e ulët të të hyrave vetanake në nivel komunal, fokusi duhet të shkojë kah:

Absorbimi i fondeve nga donatorët ndërkombëtar. Në këtë aspekt, është e nevojshme që të punohet me zyrtarët komunal, posaçërisht me Departamentin e Financave, në mënyrë që zyrtarët të trajnohen se si t'i

tërheqin këto fonde dhe si të përdoren ata në mënyrë më efikase, të menaxhohen në mënyrë efektive, dhe të kanalizohen për qëllime të promovimit të programeve dhe iniciativave që përfundimisht do të çojnë drejt përmirësimit të mirëqenies sociale në përgjithësi, dhe promovimin dhe vizibilitet më të lartë të të drejtave të fëmijëve në veçanti.

Avokimi në nivelin qendror për të dizajnuar dhe promovuar ligje që mbrojnë të drejtat e fëmijëve:

Duke u bazuar në atë se si shkon procesi i përgatitjes së buxhetit, është mjaft e qartë se resurset financiare komunale janë të rregulluara nga korniza ligjore, megjithatë, siç ceket në Nenin 8 të Ligjit për Financimin të Pushteti Lokal, të hyrat vetanake mund të shkojnë përtej listës ekskluzive të të hyrave në rastet kur këto kategori të reja të mbledhjes së të ardhurave do të parashiheshin në Ligjet e Republikës së Kosovës. Kjo bën thirrje për nevojën e avokimit në nivelin qendror për hartimin e një ligji konkret që e mbulon ekskluzivisht fushën e promovimit të të drejtave të fëmijëve në pajtim me Konventën e KB mbi të Drejtat e Fëmijëve e rrjedhimisht kjo do të garantonte një burim të qëndrueshëm të financimeve për promovimin e nevojave të fëmijëve në Kosovë. Një tjetër alternativë e përshtatshme do të ishte të kërkohej themelimi i një granti të veçantë, që do të përdorej ekskluzivisht për të mbuluar shpenzimet e programeve dhe aktiviteteve që promovojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Vlerësim i nevojave të qytetarëve në nivel komunal - Momentalisht planifikimi buxhetor komunal bazohet në disa mostra të formuara dhe të definuar saktësisht, ku ka raste të disa kategorive buxhetore të kopjuara dhe të bartura nga viti në vit pa marrë parasysh ndryshimet e dukshme në ato fusha të caktuara. Rrjedhimisht, në mënyrë që t'i përdorim burimet në mënyrë më efikase, ka nevojë për një:

Vlerësim të nevojave të qytetarëve me fokus të veçantë në nevojat e fëmijëve: Praktikën e njëjte që tani është duke e ndjekur Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me mbështetje nga UNDP për të identifikuar nevojat e qytetarëve në këtë fushë, e njëjta mund të aplikohet në sektorët tjerë, që përfundimisht do të çonte drejt proceseve buxhetore më lehtë të monitorueshme dhe të orientuara kah promovimi i të drejtave të fëmijëve.

SHTOJCAT

SHTOJCA 1: STATISTIKAT NË SEKTORIN E SHËNDETËSISË 2010-2014

KATEGORIA	2010	2011	2012	2013	2014
BPV REALE	4,204,300,000.00	4,594,600,000.00	4,949,900,000.00	5,232,800,000.00	N/A
BUXHETI I KOSOVËS	1,129,509,680.00	1,414,927,737.00	1,512,647,064.00	1,591,512,602.00	1,589,324,952.00
MINISTRIA E SHËNDETËSISË	70,825,192.00	79,079,229.00	88,168,425.00	107,459,989.00	114,707,481.00
SHPENZIMET E SHËNDETËSISË SI % E BPV	1.68%	1.72%	1.78%	2.05%	N/A
SHPENZIMET NË SHËNDETËSI SI % E BT	6.27%	5.59%	5.83%	6.75%	7.22%
DALLIMET NË BUXHETIN E MSH VIT PAS VITI(%)	N/A	11.65%	11.49%	5.21%	6.74%
DALLIMET NË BUXHETIN E MSH VIT PAS VITI (EUR)	N/A	8,254,037.00	9,089,196.00	19,291,564.00	7,247,492.00

■ Tabela 1: Indikatorët ekonomik dhe alokimet buxhetor për sektorin e shëndetësisë në Kosovë 2010-2014

KATEGORIA	2010	2011	2012	2013	2014
MINISTRIA E SHËNDETËSISË	70,825,192.00	79,079,229.00	88,168,425.00	107,459,989.00	114,707,481.00
BUXHETI I KOMUNËS SË PEJËS	17,433,674.73	19,345,551.85	19,621,018.46	20,952,752.86	19,982,046.10
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MS	2,236,914.92	2,483,782.29	2,629,801.73	2,732,688.71	2,703,139.94
BUXHETI I DSHMS	12.83%	12.84%	13.40%	13.04%	13.53%
BUXHETI I KUJDESI PRIMAR SHËNDETËSOR	2,087,924.44	2,278,037.29	2,390,870.73	2,475,088.71	2,459,839.94
NDRYSHIMI NGA VITI NË VIT (EUR)	N/A	190,112.85	112,833.44	84,217.98	(15,248.77)
NDRYSHIMI NGA VITI NË VIT (%)	N/A	9.11%	4.95%	3.52%	-0.62%
KUJDESI PRIMAR SI % BUXHETIT TOTAL	11.98%	11.78%	12.19%	11.81%	12.31%

■ Tabela 2: Shpenzimet për shëndetësi si % e buxhetit total; shpenzimet për shëndetësi primare si % e buxhetit të DSHMË në Komunën e Pejës

KATEGORIA	2010		2011		2012		2013		2014	
	BUXHETI TOTAL	% E BUXHETIT	BUXHETI TOTAL	% E BUXHETIT	BUXHETI TOTAL	% E BUXHETIT	BUXHETI TOTAL	% E BUXHETIT	BUXHETI TOTAL	% E BUXHETIT
PAGAT DHE MËDITJET	1,512,990.52	72.46%	1,736,639.00	84.31%	1,776,033.90	74.28%	1,793,256.47	72.45%	1,783,025.94	72.49%
MALLRA DHE SHËRBIME	220,258.92	10.55%	223,178.29	10.83%	434,422.00	18.17%	468,600.00	18.93%	477,600.00	19.42%
SHËRBIME KOMUNALE	104,675.00	5.01%	100,000.00	4.85%	99,660.00	4.17%	102,214.00	4.13%	99,214.00	4.03%
TRANSFERE DHE SUBVENCIONE		0.00%		0.00%	-	0.00%	-	0.00%	-	0.00%
SHPENZIME KAPITALE	250,000.00	11.97%	-	0.00%	80,754.83	3.38%	111,018.24	4.49%	100,000.00	4.07%
TOTAL	2,087,924.44		2,059,817.29		2,390,870.73		2,475,088.71		2,459,839.94	

■ Tabela 3: Buxheti për shëndetësi në Komunën e Pejës për kategoritë buxhetore si % e buxhetit total 2010-2014

KATEGORIA	2010			2011			2012			2013		
	PLANIFIKUARA	EKZEKUTUARA	%	PLANIFIKUARA	EKZEKUTUARA	%	PLANIFIKUARA	EKZEKUTUARA	%	PLANIFIKUARA	EKZEKUTUARA	%
PAGAT DHE MËDITJET	1,512,990.52	1,512,754.94	99.98%	1,736,639.00	1,729,106.08	99.57%	1,776,033.90	1,775,791.93	99.99%	1,793,256.47	1,778,245.53	99.16%
MALLRAT DHE SHËRBIMET	220,258.92	212,998.31	96.70%	223,178.29	223,037.93	99.94%	434,422.00	434,159.16	99.94%	468,600.00	468,573.74	99.99%
SHPENZIMET KOMUNALE	104,675.00	104,617.63	99.95%	100,000.00	99,991.21	99.99%	99,660.00	99,649.77	99.99%	102,214.00	102,156.89	99.94%
TRANSFERET DHE SUBVENCIONET	-	-	-	-	-	-	-	-	0.00%	-	-	0.00%
SHPENZIMET KAPITALE	250,000.00	193,117.07	77.25%	-	-	-	80,754.83	69,891.36	86.55%	111,018.24	111,018.24	100.00%
TOTAL	2,087,924.44	2,023,487.95	96.91%	2,059,817.29	2,052,135.22	99.63%	2,390,870.73	2,379,492.22	99.52%	2,475,088.71	2,459,994.40	99.39%

■ Tabela 4: Buxheti për shëndetësi në Komunën e Pejës për kategoritë buxhetore

SHTOJCA 2: STATISTIKAT NË SEKTORIN E ARSIMIT

KATEGORIA	2010	2011	2012	2013	2014
BPV REALE	4,204,300,000.00	4,594,600,000.00	4,949,900,000.00	5,232,800,000.00	
BUXHETI I KOSOVËS	1,129,509,680.00	1,414,927,737.00	1,512,647,064.00	1,591,512,602.00	1,589,324,952.00
MASHT	37,709,899.00	34,817,820.00	40,984,755.00	45,705,848.00	50,297,252.00
% E BT	3.34%	2.46%	2.71%	2.87%	3.16%

■ Tabela 1: Indikatorët ekonomik dhe buxheti për MASHT

VITI	PAGAT	% TOTAL	MALLRAT/SHËRB.	% TOTAL	SHËRB.KOM.	% TOTAL	TRANSFERET	% TOTAL	SHP. KAP	% TOTAL	TOTAL
2010	3,569,217.00	9.46%	7,737,153.00	20.52%	729,018.00	1.93%	219,730.00	0.58%	23,488,781.00	62.29%	37,709,899.00
2011	4,835,803.00	13.89%	4,820,807.00	13.85%	817,657.00	2.35%	1,265,478.00	3.63%	23,138,075.00	66.45%	34,817,820.00
2012	5,836,856.00	14.24%	8,214,353.00	20.04%	817,657.00	2.00%	1,810,478.00	4.42%	24,305,411.00	59.30%	40,984,755.00
2013	7,894,360.00	17.27%	8,873,546.00	19.41%	1,204,690.00	2.64%	4,872,252.00	10.66%	22,861,000.00	50.02%	45,705,848.00
2014	10,089,035.00	20.06%	9,956,656.00	19.80%	1,274,157.00	2.53%	3,977,404.00	7.91%	25,000,000.00	49.70%	50,297,252.00

■ Tabela 2: Buxheti për shëndetësi i ndarë në kategori buxhetore në Kosovë

MASHT	37,709,899.00	34,817,820.00	40,984,755.00	45,705,848.00	50,297,252.00
NDRYSHIMI NGA VITI NË VIT(EUR)	N/A	(2,892,079.00)	6,166,935.00	4,721,093.00	4,591,404.00
NDRYSHIMI NGA VITI NË VIT(%)	N/A	-8.31%	17.71%	11.52%	10.05%
ARSIMI PARAUNIVERSITAR	4,292,479.00	4,786,775.00	5,398,699.00	5,576,099.00	4,785,942.00
ARSIMI/NEVOJA TË VEÇANTA	1,318,134.00	1,645,831.00	1,645,831.00	1,645,831.00	1,645,831.00
TRAJNIMET E MËSUESVE	1,936,039.00	1,035,745.00	935,745.00	935,745.00	861,195.00
PROGRAMI I ARSIMIT BAZIK				1,000,000.00	1,000,000.00

■ Tabela 3: Buxheti për MASHT dhe ndryshimet nga viti në vit

ARSIMI	ADMINISTRIMI	% TOTAL	PARASHKOLLOR	% TOTAL	FILLOR	% TOTAL	I MESËM	% TOTAL	TOTAL
2010	76,694.00	1.23%	309,458.39	4.97%	4,139,118.65	66.52%	1,697,379.76	27.28%	6,222,650.80
2011	345,703.39	4.23%	315,694.72	3.86%	4,984,824.27	60.98%	2,528,112.37	30.93%	8,174,334.75
2012	605,986.46	7.42%	333,319.12	4.08%	4,874,320.47	59.68%	2,353,150.04	28.81%	8,166,776.09
2013	1,010,065.97	11.84%	327,764.45	3.84%	4,908,598.85	57.53%	2,285,882.00	26.79%	8,532,311.27
2014	1,050,182.90	12.34%	341,604.31	4.01%	4,683,878.69	55.03%	2,436,577.33	28.62%	8,512,243.23

■ Tabela 4: Buxheti për arsim në Komunën e Pejës dhe ndarja në kodet buxhetore

VITI	KATEGORIA	PAGA DHE MEDITJE	MALLRA DHE SHËRBIME	SHËRBIME KOMUNALE	TRANSFERE DHE SUBVENCIONE	SHPENZIME KAPITALE	BUXHETI PËR ARSIM
2010	ALOKUARA	5,321,981.72	405,119.03	106,602.00	-	388,948.05	6,222,650.80
	% E BUXHETIT	85.53%	6.51%	1.71%		6.25%	
2011	ALOKUARA	6,770,903.71	868,546.24	134,120.80	-	400,764.00	8,174,334.75
	% E BUXHETIT	82.83%	10.63%	1.64%	0.00%	4.90%	
2012	ALOKUARA	6,989,967.62	796,439.47	130,000.00	-	250,369.00	8,166,776.09
	% E BUXHETIT	85.59%	9.75%	1.59%	0.00%	3.07%	
2013	ALOKUARA	7,097,000.77	942,941.52	130,000.00	-	362,369.00	8,532,311.27
	% E BUXHETIT	83.18%	11.05%	0.02	0.00%	4.25%	
2014	ALOKUARA	7,075,811.07	877,691.67	130,000.00	-	428,740.49	8,512,243.23
	% E BUXHETIT	83.13%	10.31%	1.53%	0.00%	5.04%	

■ Tabela 5: Buxheti për arsim në Komunën e Pejës dhe ndarja për kategori buxhetore

SHTOJCA 3: STATISTIKAT NË SEKTORIN E MIRËQENIES SOCIALE

KATEGORIA	2010	2011	2012	2013	2014
BPV REALE	4,204,300,000.00	4,594,600,000.00	4,949,900,000.00	5,232,800,000.00	
BPV PËR FRYMË BANORI	2,480.00	2,672.00	2,799.00	2,935.00	
BUXHETI I KOSOVËS	1,129,509,680.00	1,414,927,737.00	1,512,647,064.00	1,591,512,602.00	1,589,324,952.00
MPMS	174,049,273.00	201,404,460.00	212,181,578.00	222,059,372.00	230,262,930.00
MPMS SI % KB	15.41%	14.23%	14.03%	13.95%	14.49%
MIRËQENIA SOCIALE	35,040,945.00	34,616,614.00	36,025,858.00	34,470,031.00	34,559,069.00
% E BPV	0.83%	0.75%	0.73%	0.66%	
% E BUXHETIT MPMS	20.13%	17.19%	16.98%	15.52%	15.01%
SKEMA SOCIALE	29,470,537.00	28,783,700.00	28,664,339.00	27,998,274.00	27,851,335.00
% MPMS	84.10%	83.15%	79.57%	81.22%	80.59%
SHËRBIMET SOCIALE	3,364,131.00	3,463,088.00	4,526,157.00	3,784,383.00	3,926,016.00
% MPMS	9.60%	10.00%	12.56%	10.98%	11.36%

■ Tabela 1: Buxheti për MPMS dhe trendët për kategoritë buxhetore

KATEGORIA	2010	2011	2012	2013	2014
BUXHETI I QPS (NIVELI QENDROR NË MILIONA EUR)	2.08	2.01	2.82	2.64	2.67
DALLIMI VIT PAS VITI(EUR)	N/A	-0.07	0.81	-0.18	0.03
DALLIMI VIT PAS VITI (%)	N/A	-3.40%	40.30%	-6.40%	1.10%
BUXHETI I QPS NË PEJË	121,883.16	90,405.00	202,763.75	213,500.88	187,800.84
DALLIMI VIT PAS VITI (EUR)	N/A	(31,478.16)	112,358.75	10,737.13	(25,700.04)
DALLIMI VIT PAS VITI(%)	N/A	-25.83%	124.28%	5.30%	(0.14)

■ Tabela 2: Buxheti për QPS në nivel qendror dhe lokal

SHTOJCA 4: LISTA E TË INTERVISTUARVE

EMRI DHE MBIEMRI	POZITA
MENTOR MORINA	UDHËHEQËS I DIVIZIONIT PËR PLANIFIKIM DHE PËRFSHIRJE SOCIALE, MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
NASER LAJQI	OJQ ' SYRI I VIZIONIT,' PEJË
PETRIT LOCI	DREJTOR I DREJTORISË PËR SHËNDËTËSI DHE MIRËQENIE SOCIAL, KOMUNA E PEJËS
JETON ABAZI	DREJTOR I DEPARTAMENTIT TË FINANCAVE, KOMUNA E PEJËS
BESIM AVDIMETAJ	DREJTOR I DEPARTAMENTIT TË ARSIMIT, KOMUNA E PEJËS
ARB NOR MUQA	OJQ 'INICIATIVA 6,' PEJË

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

341.231.14-053.5:336.14(496.51-2)

Nxitja e shpenzimeve në nivelin lokal me fokus në drejtat e fëmijëve: një studim i buxhetit të Komunës së Pejës me fokus në promovimin e të drejtave të fëmijëve / Instituti për Politika Zhvillimore. - Prishtinë: Save the Children, 2014.
– 54 f.: ilustr. me ngjyra; 30 cm.

ISBN 978-9951-534-29-1

ISBN 978-9951-534-29-1





Save the Children

Save the Children lufton për të drejtat e fëmijëve. Ne ofrojmë përmirësime të menjëhershme dhe të qëndrueshme në jetën e fëmijëve në mbarë botën.

Save the Children

Gazmend Zajmi nr. 1, 10000 Prishtinë Kosovë

Phone: +381 (0) 38 23 26 91

Fax: +381 (0) 38 23 26 93

scik@savethechildren.org

www.savethechildren.net

www.kosovo.savethechildren.net

<https://www.facebook.com/savethechildreninkosova>